

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7557 E martë 12 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Përfitimi i statusit të vendit kandidat të Shqipërisë për në BE dhe çështja e hapjes së negociatave në fund të këtij muaji, midis të tjerave, me gjasë do ...
Vijon në faqet 20-21

Nga ANDON ANDONI

Negociatat, si njëqind vjet më parë



Dje *në* "Deutsche Welle"

Disa analistë thonë se ish-Jugosllavia (RSFJ) ka pasur forcat më të fuqishme të armatosura ajrore në rajon - Armata Popullore e Jugosllavisë renditej...
Vijon në faqet 21

Nga SAMIR HUSEINOVIÇ

Kush e ruan hapësirën ajrore të Serbisë dhe rajonit?



"Ja përplasa kokën disa herë në dysheme"

Vrau gruan, nuk pendohet: E bëra se kisha dyshime se më tradhtonte

Çlirim Shaholi masakroi nënën e 6 fëmijëve, rizikoi burgun përjetë: Shkonte me pronarin

KLODIANA HAXHIHAJ

DURRËS - I qetë dhe pa asnjë shenjë pendese në fytyrë ka hyrë dje në sallën e gjyqit Çlirim Shaholi, i cili mbrëmjen e së premtes që shkoi vrau në mënyrë makabre gruan e tij, nënën e 6 fëmijëve. I braktisur nga të afërmit...

Në faqen 9

EMRAT/ LISTA E RE E ATP: SHUMA E PARAVE QE MERR SECILI PRONAR

PRONAT, KOMPENSIMI PER VITET 1999-2000

Agjencia e Pronave publikon regjistrin për 12 qarqet: Ja kujt i është njohur e drejta e përfitimit nga fondi. Vendimet e reja edhe për vitet '93-'98



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

Në faqet 12-16

ISH-KRYEPROKURORI



Adriatik Llalla
i shpëton vetëgjyqit:
Largimi nga detyra u bë sipas ligjit

Në faqen 7

Dokumenti që "skanon" Shqipërinë: Tolerancë fetare, por edhe shumë azilantë

Raporti i PE: Të hapen negociatat pa kushte

Fleckenstein: Ekonomi informale, të përdoren me efektivitet fondet e BE

Nga DARINA TANUSHI

Komiteti i Jashtëm i Parlamentit Evropian për Shqipërinë ka publikuar raportin mbi Shqipërinë, të cilin ia ka adresuar Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian. Sipas raportuesit për vendin tonë, Knut Fleck-



enstein, Shqipëria meriton çeljen pa kushte të negociatave, por nga ana tjetër kërkon më shumë bashkëpunim nga palët politike për konsolidimin e reformave në vend. Raportuesi Knut Fleckenst kërkon çeljen pa kushte të negociatave për ...

Në faqen 3

TEATRI KOMBETAR

Artistët, ultimatum qeverisë: Anuloni shembjen, ose do e uzurpojmë

Në faqen 19

PREMTIMI

Rama: Për 5 vite numri i turistëve mund të shkojë deri në 10 milionë

Në faqen 4

PROPOZIMI

Ndryshimi në ligjin e mediave audiovizive, pronarët gjejnë konsensus tek AMA

Në faqen 11

EKONOMIA

Ahmetaj: Punësimi u rrit me 4.9%. PD: 400 mijë vota ikën nga Shqipëria

Në faqen 10

INTEGRIMI NEGOCIATAT

Zëvendësi i Merkel në CDU/CSU, Wadehul: Tahiri 'peshk i madh'. Xhafaj duhet të largohet

Gjermania: Shqipëria nuk ka plotësuar kushtet për negociatat

"Në rrjetë kanë rënë vetëm 'peshq të vegjël'"

Gjermania shpreh bindjen se Shqipëria nuk ka plotësuar asnjë kusht për hapjen e negociatave. Zëvendësi i Kancelares Merkel në CDU/CSU, dr. Johann David Wadehul në një intervistë ekskluzive për kryeredaktoren e "Opinion", Desada Meta, shpreh se nuk janë plotësuar kushtet e BE që do të çonin në hapjen e negociatave në fund të këtij muaji. Sipas z. Wadehul peshqit e mëdhenj janë të paprekur; në rrjetë kanë rënë vetëm peshq të vegjël. Po kaq, ai shpreh se Tahiri është peshk i madh dhe se çështja e tij është pengesë reale për hapjen e negociatave. Duke iu referuar deklaratave të ambasadorit amerikan Donald Lu, Wadehul shpreh: "Edhe ambasadori Lu që nuk është shquar si mik i opozitës e pranon që Tahirin po e mbrojnë". Z. Wadehul shpreh, gjithashtu, pa ekuivokë kur insiston se duhet të zhbllokohet Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë. Ai po ashtu shpreh shqetësimin se në Shqipëri është rritur trafiku i të gjitha drogave. Mesazh të prerë ai jep edhe kur deklaron se Reforma Zgjedhore kusht i rëndësishëm për hapjen e negociatave. Emërimet në administratë, sidomos në nivelet e larta, janë në shkëlqje të ligjit deklaroi ai. Z. Wadehul foli për dorëheqjen e ministrit të Brendshëm ku deklaron se Fatmir Xhafaj nuk mund të qëndrojë si ministër pasi është në konflikt interesi. Mosdorëheqja e tij është në kundërshtim me standardet e BE për shtetin ligjor dhe pengesë për hapjen e negociatave.

Z. Wadehul, në Shqipëri është perceptuar skepticizmi i Bundestagut për hapjen e negociatave. Me çfarë është lidhur kryesisht ky qëndrim i parlamentarëve gjermanë?

Ne duam që Shqipëria të mund të fillojë sa më parë negociatat e anëtarësimit. Në marrëveshjen e koalicionit mes CDU / CSU dhe SPD është shumë e qartë: "Kushti për hapjen e negociatave për anëtarësim është që vendet e Ballkanit Perëndimor të përmbushin plotësisht kriteret e duhura". Por kjo nuk ka ndodhur as në reformën në drejtësi, as në luftën kundër korrupsionit - veçanërisht korrupsionit të rangut të lartë - as në luftën kundër krimit të organizuar; pra në asnjë nga kriteret kryesore.

Atëherë, çfarë tjetër duhet bërë përpara se negociatat e anëtarësimit të mund të fillojnë me hapjen e kapitujve të parë negociues? Si pjesë e



Zëvendësi i Kancelares Merkel në CDU/CSU, dr. Johann David Wadehul

reformës në drejtësi, vetëm pak nga rreth 800 gjyqtarë dhe prokurorë u janë nënshtruar të ashtuquajturit veting. Së paku, duhet të përfundojë plotësisht verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjykatave të instancave të larta dhe prokurorive, si dhe të organeve të apelit. Gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilëve u janë vërtetuar vepra të dëmshme në procesin e verifikimit (vetingut) duhet të jenë subjekt i procedimeve penale. Duhet të fillojë puna dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatave të instancave të larta dhe SPAK -ut. Kultivimi

i kanabisit ra në mënyrë drastike në vitin 2017. Në të njëjtën kohë, megjithatë, është rritur trafikimi i drogës, dhe kundra kësaj duhet luftuar në mënyrë të qëndrueshme dhe vazhdueshme. Zyrtarë të lartë në ministrinë dhe drejtoritë e administratës publike u rekrutuan direkt pa konkurs, në kundërshtim me ligjin e shërbimit civil. Kjo është thyerje e ligjit dhe duhet të korrigohet. Përveç kësaj, që nga viti 2013, OSBE dhe BE kanë kërkuar reformë zgjedhore, por asgjë nuk ka ndodhur që atëherë - kjo është një shpërfillje e madhe ndaj OSBE dhe BE!

Ballkani, Hahn: Nuk ka integrim pa kalimin e fazave me radhë

Procesi i integritimit për Ballkanin Perëndimor nuk ka kapërcim fazash", është shprehur eurokomisioneri për zgjerimin Johannes Hahn. Ai mbajti një leksion në Vjenë ku foli për strategjinë e Ballkanit Perëndimor, duke pasur parasysh dhe faktin se Austria merr presidencën e radhës të BE në korrik. "Strategjia e Ballkanit Perëndimor është parë si një dokument i rëndësishëm për të risjellë në agjendë zgjerimin e Bashkimit Europian. Presidencë austriake është një dritare e rëndësishme mundësisht", u shpreh z. Hahn. Në fund të qershorit BE pritet të vendosë për çeljen ose jo të negociatave për Shqipërinë.



JOHANN WADEPHUL
Numri dy i partisë së Kancelares Merkel në CDU/CSU, dr. Johann David Wadehul, zv. kryetari i Grupit Parlamentar CDU/CSU në Bundestag, përgjegjës për politikën e jashtme, të sigurisë dhe Këshillin e Europës, dhe kreu i Grupit të Punës për Ballkanin Perëndimor.

EDMOND SPAHO
"Pra, opozita paska të drejtë që këmbëngul që të largohet Xhafaj dhe të mos i jepet mbrojtje politike Tahirit, ndryshe nuk hapen negociatat. Po tani a do dëgjojë pashai dhe karvani i tij i papagallëve që thonë se fajin e ka opozita që nuk hapen negociatat? Apo do thonë që këtë e ka 'blerë' opozita?". - deklaroi kreu i deputetëve të PD-së.

Parlamenti shqiptar duhet të miratojë reformën zgjedhore në përputhje me planin e saj të punës deri në fund të vitit 2018. Ky është një kusht i domosdoshëm për ne deputetët, në mënyrë që të mund të votojmë pro hapjes së negociatave.

Negociatat e Shqipërisë me BE janë një çështje tepër e rëndësishme për shqiptarët. Mendoni se qeveria e Edi Ramës ka punuar mjaftueshëm për të plotësuar kushtet e vendosura nga Brukseli?

Shumë vendime janë marrë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Por në realitet, shumë pak është bërë: korrupsionit mbetet ende një problem në të gjithë sektorin e drejtësisë. Ligjet ekzistuese dhe procedurat për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar janë aplikuar shumë më pak në mënyrë strikte ndaj zyrtarëve të lartë dhe politikaneve sesa ndaj zyrtarëve të mesëm dhe të ulët dhe ndaj qytetarëve të zakonshëm. Kështu që "peshqit e vegjël" u kapën dhe u dënuan, "peshqit e mëdhenj" mundën të depërtonin jashtë rrjetës. Këtu kemi të bëjmë me shpërfilljen e një kushti themelor të sundimit të ligjit, i cili është trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve para ligjit. Për aq kohë sa kemi të bëjmë me një shkëlqje të hapur të parimeve themelore të sundimit të ligjit të BE-së, kapitujt negociues nuk mund të

hapen.
Si e shihni problemin që ka qeveria shqiptare me Ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, i cili po gjykohej për përfshirjen në një organizatë të strukturuar ndërkombëtare për trafikun e lëndëve narkotike? Mendoni se drejtësia dhe instrumentet e saj janë ndikuar nga qeveria për këtë skandal?

Çështja Tahiri është një "peshk i madh". Në këtë çështje kemi të bëjmë deri sot me shkëlqje të hapur të parimeve themelore të shtetit ligjor. Kjo çështje është një pengesë reale për hapjen e negociatave. Nëse ambasadori amerikan Donald Lu hedh akuza kaq të forta, atëherë duhet ta marrim këtë shumë seriozisht, sepse ambasadori Lu deri tani nuk ka rënë në sy si mik i opozitës.

Ndërkohë edhe ministri aktual i Brendshëm është pjesë e një skandali me të vëllain, i është dënuar dhe ai për trafik ndërkombëtar droge, ndërkohë që nuk ka vuajtur dënimin, por ka jetuar i lirë në Shqipëri?

Në ditë të mëdha sipas fakteve të paraqitura dhe legjislacionit, ministri i Brendshëm është në këtë rast në konflikt interesi. Për kredibilitetin e vet ndaj popullit shqiptar si dhe ndaj partnerëve të tij evropianë, ministri i Brendshëm, i cili është përgjegjës për krijimin e rendit dhe ligjit, duhet të jetë i interesuar për një sqarim të



plotë të çështjes. Por kjo nuk mund të ndodhë nëse ai mbetet në detyrë si person i përfshirë. Kështu që ne ende kemi dyshime të konsiderueshme nëse ekziston vullneti politik për të praktikuar standardet ligjore të BE. Kjo nuk është një pyetje që mund të marrë përgjigje vetëm gjatë negociatave të pranimit, por duhet të kemi besim të qartë në gatishmërinë për veprimin e sundimit të ligjit para se të fillojmë negociatat e pranimit. Por, për sa kohë që këto dyshime nuk janë larguar bindshëm përmes sundimit të ligjit në mënyrë konsekuente, ne nuk mund t'i hapim kapitujt e parë të bisedimeve, të cilat janë pikërisht kapitujt e shtetit ligjor 23 dhe 24.

Shqiptarët janë të dëshiruar për të qenë sa më shpejt pjesë integrale e BE. Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë në qeverisjen e këtyre që ne ta meritojmë anëtarësimin në familjen europiane?

Siç e thashë, ne duam që Shqipëria të fillojë negociatat konkrete të pranimit sa më shpejt që të jetë e mundur. Veçanërisht edhe sepse shqiptarët janë aq të orientuar drejt Europës. Ne jemi, gjithashtu, të lumtur për miqësinë e fortë me Gjermaninë. Por jo për këtë arsye duhet t'i injorojmë problemet. Në fillim i përmenda pikat tona që duhet të përmbushen para se të fillojnë negociatat konkrete për secilin kapitull. Këtu nuk janë pengesa shumë të mëdha nëse ekziston vullneti politik për të larguar vazhdimisht korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe për të respektuar dhe zbatuar ligjin dhe rendin. Dhe qeveria shqiptare këtë nuk duhet ta bëjë për BE ose Bundestagun Gjerman, por për njërijet e saj, sepse ata e presin këtë gjë.



35 rekomandimet, zbardhet raporti i Komitetit të Jashtëm të PE për Shqipërinë

Drafti i Fleckenstein për Këshillin e BE: Të hapen negociatat pa kushte

"Shqiptarët, me numrin më të madh të azilantëve"

Darina Tanushi

Komiteti i Jashtëm i Parlamentit Europian për Shqipërinë ka publikuar raportin mbi Shqipërinë, të cilin ia ka adresuar Këshilli të Ministrave të Bashkimit Evropian. Sipas raportuesit për vendin tonë, Knut Fleckenstein, Shqipëria meriton çeljen pa kushte të negociatave, por nga ana tjetër kërkon më shumë bashkëpunim nga palët politike për konsolidimin e reformave në vend. Raportuesi Knut Fleckenstein kërkon çeljen pa kushte të negociatave për Shqipërinë, pasi ka përmbyshur 5 prioritetet kyçe. Në 35 pikat që i dërgohen Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian, Fleckenstein rendit reformat e realizuara, por kërkon gjithashtu dialog me palëve politike në vend, si një ndër pikat kyçe për integrimin e Shqipërisë. Komiteti i Jashtëm i PE-së "rithekson që dialogu konstruktiv politik, gatishmëria për kompromis dhe ruajtja e angazhimit të palekduar në zbatimin dhe konsolidimin e reformave në të gjitha pesë prioritetet kyçe janë thelbësore për përpjekjet për të çuar përpara procesin e pranimin në BE". Vëmendja e qeverisë duhet të përqendrohet në reformën në drejtësi rekomandon eurodeputeti Knut Fleckenstein. Pavarësisht se përsëritet përparimet e bëra, u bën thirrje autoriteteve shqiptare që të përshpejtojnë procesin e verifikimit pa kompromentuar cilësinë ose drejtësinë. "Përsëritet përditësimet e fundit të legjislacionit antikorrupsion të vendit, theksohen nevojën për të përfunduar themelimin e Byrosë Kombëtare të Hetimeve, të Tribunalit Special dhe të Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian lavdëroi përmirësimet e rëndësishme të bëra në kuadrin ligjor dhe institucional, me qëllim parandalimin dhe zhdukjen e korrupsionit në institucionet publike. Ai bën thirrje për përpjekje shtesë për të reduktuar korrupsionin që ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve të Shqipërisë. "Bëj thirrje për një vëmendje



Knut Fleckenstein

më të madhe që duhet t'i kushtohet korrupsionit politik dhe publik-privat dhe theksohen se një rekord bindës

mund të arrihet vetëm nëpërmjet hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në

rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet, duke përfshirë rastet e nivelit të lartë". Në draft-raport kërkohej nga autoritetet shqiptare që të ndërmarri veprime vendimtare për të çmontuar rrjetet kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore dhe të drogës dhe të rritet numri jo vetëm i hetimeve dhe ndjekjeve, por edhe i dënimeve përfundimtare. Por në fund shprehet edhe shqetësimi se Shqipëria mbetet vendi i Ballkanit Perëndimor nga i cili bëhet numri më i madh i hyrjeve dhe qëndrimeve të paligjshme dhe pretendimeve të pazabazuara për azil në shtetet anëtare.

Deputeti i PS, Bushati: Hahn caktoi 2025 për Ballkanin në BE

Deputeti socialist, Erv in Bushati konfirmoi dje se komisioneri Johannes Hann tregoi mbështetjen e tij për Shqipërinë dhe integrimin e saj në BE. "Tashmë Shqipëria ka momentin të bëmë sa më shumë progres me reformën në drejtësi dhe me procesin e vetëngut. Vendet e Ballkanit dua t'i shohim në 2025 si anëtare të BE-së. Mund të gjykohej si optimist nga disa për datën që e them sot këtu për herë të parë, por Ballkani është Europë", - është shprehur Hann, citon deputeti i PS-së. Bushati u shpreh në fjalën e tij gjatë aktivitetit ku ishte edhe komisioneri Hahn në Vjenë se, 95% e shqiptarëve kanë një dëshirë të madhe për ta parë vendin e tyre shumë shpejt në Evropë. "Procesi juaj real në procesin bashkëpunimit dhe angazhimin konstant të Europës për të mbajtur derën e hapur për vendet e Ballkanit është më frytdhënës sesa politika absurde e të mbajturit derës mbyllur, me shprehjen reale se aty jashtë dhe në të ftohtë mund të rritet vetë një fluturashu si në metamorfozë! Ky lajm i mirë për Shqipërinë dhe shqiptarët na jep vetëm kurajë për të vijuar më tej me reformat dhe për të bërë sa më shumë punë", tha Bushati.

Tabaku: Biseda me Hahn, nuk ka rrugë të shkurtër drejt BE-së

Deputetja demokrate, Jorida Tabaku, është takuar me eurodeputetin Johannes Hahn, ku ndër të tjera është folur për integrimin evropian të Shqipërisë në BE. Takimi u zhvillua gjatë një seminary të mbajtur në Vjenë, në kuadër të "Strategjinë e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor". Përmes një postimi "Facebook", deputetja e PD thekson detaje në të cilat u fokusua biseda, duke u shprehur: "Nuk ka rrugë të shkurtër drejt BE-së. Secili vend duhet të zbatojë kriteret e vendosura". "Dëgjoja me vëmendje edhe përgjigjet që komisioneri Hahn u ktheu disa prej drejtuesve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilëve u theksoi qartë se, delirët apo kërcënimet e disave për alternativat të tjera ndryshe nga BE nuk janë rruga e duhur për t'u bërë pjesë e Unionit. Një vëmendje të veçantë komisioneri Hahn i kushtoi edhe zhvillimit ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor", shkroi dje Tabaku. Sipas saj, "Shqipëria ka një shans të art në qershor 2018 për të fituar statusin, ka dëshirën e shqiptarëve dhe vullnetin e opozitës dhe miqve tanë në BE".

PIKAT E RAPORTIT TË KOMITETIT TË JASHTËM TË PARLAMENTIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË, MIRATUAR MË 4 QERSHOR

- Mirëpret përpjekjet e intensifikuara të Shqipërisë në këtë drejtim, duke çuar në një progres të qëndrueshëm në lidhje me BE-në, veçanërisht në reformën gjithëpërfshirëse të drejtësisë. Kërkon nga Shqipëria të konsolidojë reformat e arritura dhe të vazhdojë përgatitjet për detyrimet e anëtarësimit në BE në të gjithë kapitujt.
- E mbështet plotësisht rekomandimin e Komisionit që negociatat e pranimin të hapen në njëkohje të përpjekjeve të reformave të bëra nga Shqipëria; i bën thirrje Këshillit për hapjen e bisedimeve të pranimin pa vonesë për të mbështetur momentin e reformës; konsideron se hapja e negociatave do të ofronte stimuj të mëtejshëm për procesin e reformës dhe për të rritur zbatueshmërinë e tij.
- I bën thirrje Komisionit të zbatojë qasjen e përfortuar për negociatat e Kapitullit 23 (gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe Kapitulli 24 (drejtësia, liria dhe siguria).
- Kujton nevojën për të forcur kapacitetet mbikëqyrëse të Parlamentit Shqiptar, duke përfshirë në procesin e anëtarësimit në BE; mirëpret Kodin e Sjelljes së Parlamentit Shqiptar.
- Mirëpret punën nga komisioni Ad-hoc për Reformën Zgjedhore të Parlamentit Shqiptar në lidhje me arritjet e arritura dhe zgjedhjet dhe i kërkon atij që të arrijë konsensus në kohën e duhur para zgjedhjeve lokale 2019.
- Përsërit thirrjet për parti politike të vendit për të përmbyshur detyrimin e tyre për të siguruar përjashtimin e kriminelëve, shkelësve nga zyrtarë shtetërorë dhe nivelet e qeverisjes.
- Përsërit se dialogu konstruktiv politik, gatishmëria për të bërë kompromis dhe angazhimi i palekduar në zbatimin dhe konsolidimin e reformave janë thelbësore për përpjekjet për të çuar përpara BE-në, procesin e pranimin.
- Theksohen faktin se reforma e gjyqësorit është një kërkesë e madhe nga qytetarët shqiptarë dhe parakusht për rivendosjen e besimit në sundimin e ligjit.
- Përsëritet përparimin e bërë në reformën e drejtësisë që synon rritjen e pavarësisë, përgjegjësisë, profesionalizmit dhe efikasitetit të institucioneve gjyqësore; keqardhje që administrimi i drejtësisë vazhdon të jetë i ngadalshëm dhe joefikas; u bën thirrje autoriteteve shqiptare të përshpejtojnë procesin e verifikimit pa kompromentuar cilësinë ose drejtësinë; merr parasysh shkaktimet e para dhe të mëtejshme të korrupsionit dhe angazhimit të paligjshëm.
- U kërkon autoriteteve shqiptare të përfundojnë themelimin e organeve të reja gjyqësore; nënvizon nevojën për të mbështetur funksionimin efektiv të këtyre institucioneve me anë të burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.
- Përsëritet përparimin e vazhdueshëm në drejtësi të kriminit të një administrate publike me miqësore, transparente, profesionale dhe të depolitizuara, duke përfshirë edhe atë në nivel lokal.
- Kërkon forcimin e mëtejshëm të kapacitetit administrativ të institucioneve dhe organeve përgjegjëse për zbatimin e reformave të lidhura me anëtarësimitin.
- Lavdëroni përmirësimet e rëndësishme të bëra në kuadrin ligjor dhe institucional, me qëllim parandalimin dhe zhdukjen e korrupsionit në institucionet publike. Ai bën thirrje për përpjekje shtesë për të reduktuar korrupsionin që ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve të Shqipërisë.
- Përsëritet përditësimet e fundit të legjislacionit antikorrupsion të vendit. Theksohen se ka nevojë të ngrihet
- Byroja Kombëtare e Hetimit, Gjykata Speciale dhe Prokuroria Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
15. Kërkon një vëmendje më të madhe ndaj korrupsionit politik dhe atij publik-privat.
16. Përsëritet përparimet e bëra në luftën kundër kriminit të organizuar, duke përfshirë edhe progresin në konfiskimet e drogave të paligjshme dhe reduktimin e kultivimit të kanabisit.
17. Kërkon nga autoritetet shqiptare të marrin masa vendimtare për të çmontuar rrjetet kriminale.
18. Përsërit thirrjen e tij ndaj autoriteteve shqiptare për të siguruar në mënyrë efektive zbatimin e ligjit, të drejtat pronësore.
19. Mirëpret hapat shtesë të ndërmarri për të përfortuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtat e minoriteteve dhe politikën kundër diskriminimit.
20. Lavdëron kërkimin e tolerancës dhe bashkëpunimit me feve të vendit, komunitete, U bën thirrje autoritetit shqiptar që të luftojnë në mënyrë efektive fjalimin e uretjes dhe diskriminimit të pakicave, duke përfshirë personat LG-BTI.
21. U bën thirrje autoriteteve shqiptare të rrisin bashkëpunimin me shoqërinë civile, duke siguruar pjesëmarrjen dhe konsultimin efektiv të publikut gjatë gjithë kohës në procesin e vendimmarjes.
22. ...
24. Kërkon nga autoritetet shqiptare që të adresojnë ekonominë e madhe informale.
25. Theksohen nevojën për të siguruar konvergjençë pozitive në standardet shoqërore gjatë periudhës së procesit të pranimin.
26. Shpreh shqetësim për impaktet e mundshme negative mbi punësimin dhe politikën e krijimit të politikës sociale pas shkrirjes së Ministrisë së Punës në Shqipëri si rezultat i ristrukturimit qeveritar.
28. Shpreh shqetësimin për veprimtarinë ekonomike që ka çuar në dëmtimin e mjedisit në zonat e mbrojtura, të tilla si hidrocentralet përgjatë lumit Vjosa.
29. Shpreh shqetësimin se Shqipëria mbetet vendi i Ballkanit Perëndimor nga i cili janë bërë kërkesat më të mëdha të hyrjeve dhe qëndrimeve të paligjshme, si dhe pretendimeve e pazabazuara për azil, në shtetet anëtare të BE.
30. Lavdëron suksesin e Shqipërisë në frenimin e daljes së luftëtarëve të huaj.
31. Mirëpret pjesëmarrjen e Shqipërisë në Procesin e Berlinit në iniciativën e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe nisimave të tjera rajonale; mirëpret rolin rajonal të Shqipërisë në promovimin bashkëpunimit kooperativ dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore me vendet e tjera të zgjerimit dhe me shtetet anëtare fqinje.
32. Përgëzojnë Shqipërinë për shtrirjen e saj të vazhdueshme të plotë me të gjitha pozicionet e BE-së në deklaratat e bëra në kontekstin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.
33. U bën thirrje autoriteteve shqiptare të bëjnë përdorimin me efektiv të fondeve të BE-së në të gjitha rajonet e vendit; i bën thirrje Komisionit të sigurojë kushtëzimit të rreptë të instrumentit të para-Anëtarësimit (IPA).
34. Vërejtje atmosferë konstruktive në takimin e 12-të të BE-Shqipëri. Komiteti Parlamentar i Stabilizimit-Asocimit (SAPC), mbajtur në Tiranë më 12-13 shkurt 2018 vë në dukje bashkëpunimin e përmirësuar të arritur në mes të shumicës dhe përfaqësuesve të opozitës në SAPC; nënvizon rëndësinë e një bashkëpunimi të vazhdueshëm ndërpartak në rrugën e reformës drejt pranimin të BE.

PUNËSIMI KRYEMINISTRI

Kryeministri: Shqipëria është ende peng i prapambetjes së zanateve

Rama: Brenda 5 viteve numri i turistëve mund të shkojë 10 mln

"Garantojmë punësim të vazhdueshëm përmes turizmit"

Darina Tanushi

Vitin e kaluar nga turizmi ka pasur 42 mijë të punësuar. Në 10 vitet e ardhshme presim që të shkojë në 250 mijë", deklaroi dje kryeministri Edi Rama gjatë një takimi në Durrës me të punësuarit në turizëm. Rama u shpreh se brenda 5 viteve numri i turistëve që mund të vizitojnë Shqipërinë mund të shkojë në 10 milionë. Por për të arritur objektivat, sipas tij duhen investime, ndërsa mori shembullin e Malit të Zi. "Shqipëria është ende peng i prapambetjes së profesionëve dhe zanateve që i duhen tregut të punës. Ata që mbarojnë arsimin profesional, kanë mundësi për të hyrë më shpejt në punë. Ne nuk mund të rrisim rrogat sa kemi dëshirën, por një familje dhe një vend që jeton jashtë mundësive të veta, përvëlhet pastaj. Duhet të jetojë brenda mundësive të veta", u shpreh Rama. "Vende pune ka për financiarë, teknologë dhe ekonomisë, por puna nuk vjen të shtëpia që të thotë 'çohu nga gjumi të pimë një kafe një herë dhe të shohim ç'do bëjmë'. Në sektorin e turizmit ka një potencial të jashtëzakonshëm. Këtu janë ardhur 6 kuzhinierë turq, ndërsa ne menduam për 20 e ca vite vetëm për juristë. Edhe Mali i Zi është para nesh, se këtu u lejua kaosi në vijën bregdetare", theksoi gjatë fjalës së tij Rama. Ai u ka treguar të rinjve se pak ditë më parë ishte në kantierin e kompresorëve të gazsjellësit Trans-Adriatik. "Imagjinojeni vetë, saldatorë nga Tajlanda, nga Pakistani, nga Turqia. Në stadiumin e ri kombëtar që po ndërtohet në Tiranë, saldatorët, shumica dërrmuese janë të huaj, që lënë shtëpitë e tyre në vende të largëta, vijnë dhe punojnë në Shqipëri. Nga njëra anë, sepse ata vetë duan të punojnë, nga ana tjetër, Shqipëria është ende peng i një prapambetjeje disa dekadash, ku u hap një boshllëk i madh



Kryeministri Edi Rama, dje në Durrës

në pikëpamje të profesionëve, të zanateve, që i duhen tregut të punës", u tregoi Rama të rinjve të punësuar në turizëm. Ai tha se ata që mbarojnë arsimin profesional mund të gjejnë më shpejt punë se të tjerët. "Këtë vit vetëm në 3-mujorin e parë kemi 12-13% rritje të numrit të turistëve dhe do të arrijmë mbi 15% rritje. Brenda 5 viteve mund të shkojmë në 10 milionë turistë, por natyrisht na duhen investime, sepse na duhen sh-

tretër. Kemi një numër të kufizuar shtretërisht në raport me kërkesën. E dinë shumë mirë edhe ata që kanë investuar dhe investojnë në turizëm, se kur bëjnë konstatat, i bëjnë me një pjesë të asaj që kërkohet, sepse numri që kërkohet është shumë më i lartë. Fluksi i turistëve nga vendet nordike, nga Suedia, Norvegjia, Danimarka, Finlanda, Islanda tregon se Shqipëria është krejt e kundërta që shpeshherë, rëndom, një

SHIFRAT
"Këtë vit, vetëm në 3-mujorin e parë kemi 12-13% rritje të numrit të turistëve dhe do të arrijmë mbi 15% rritje. Brenda 5 viteve mund të shkojmë në 10 milionë turistë, por natyrisht na duhen investime, sepse na duhen shtretër", tha dje Rama.

pjesë e jona e pikturojnë. Është një vend i bukur, një vend që ka çfarë ofron dhe një vend ku jo vetëm vijnë, por edhe rikthehen, që është një gjë shumë e rëndësishme. Ama ne duhet të bëjmë shumë më tepër. Për këtë arsye po bëjmë stimulim maksimal të fuqizimit të industrisë së turizmit, sepse nëpërmjet industrisë së turizmit do të garantojmë një punësim të vazhdueshëm real", tha më tej Rama.

Të rinjtë e FRPD dhe LRI protestojnë para zyrës së Ramës, përplasen me policinë

Forumi Rinor i Partisë Demokratike dhe Lëvizja Rinore për Integritim protestuan dje sërish kundër ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Ndryshe nga protestat e kaluara, të cilat janë zhvilluar përpara zyrës së Xhafajt, protestuesit dje u drejtuan Kryeministrisë, ku edhe kanë shënuar një incident me policinë. Ata kanë mbajtur në duar banderola në formë bilete avioni, të përgatitura në mënyrë simbolike. Këto banderola ata i kanë lënë para Kryeministrisë, duke i kërkuar kryeministrit Rama të largohet. Kanë qenë Belind Këlliçi dhe



Klevvis Balliu në krye të disa protestuesve drejt godinës së Këshillit të Ministrave ndërsa janë përplasar edhe me policinë. Belind Këlliçi dhe Klevvis Balliu janë parë duke shtyrë policët.

ë tubimit për shkak se nuk kishin leje. Në këtë moment të rinjtë u përplasën edhe me policinë. Belind Këlliçi dhe Klevvis Balliu janë parë duke shtyrë policët.



Gjatë një seance parlamentare

Emigrantët nga Lindja, Bushati: Nuk mund të kapërcejmë kapacitetet, jemi të gatshëm

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Dimitri Bushati deklaroi dje se beson se në fund të këtij muaji Këshilli i Bashkimit Europian do t'i hapë një perspektivë të qartë Shqipërisë. Bushati pati dje një interpellancë me një grup studentësh sa i përket temës së negociatave. "Shqipëria - tha ai - është gati për t'u ulur në tryezën e bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Europian, pasi ka përbushur të gjitha detyrimet për këtë fazë të procesit. "Ne synojmë të ulemi në tryezën e bisedimeve dhe të hapim një kapitull të ri në marrëdhëniet me BE-në, që nuk do të mbyllet nesër, por do të ketë përpara sfida", - tha Bushati. Ndërkohë, në një intervistë për "ABC News", Bushati deklaroi se për çështjen e emigrantëve, "Shqipëria nuk mund të kapërcejë kapacitetet e saj, në përballimin e situatës së emigrantëve nga Lindja e Mesme, pavarësisht situatave gjeopolitike". Mes të tjerash, ai tha se qeveria shqiptare është e gatshme të përgjigjet, bazuar tek solidariteti dhe proporcionaliteti në këtë situatë. Më herët, gjatë interpellancës, ai theksoi se, "vendet anëtare do të mblidhen në formatin e ministrave të Jashtëm në 25 qershor dhe në formatin e kryeministrave në 28 qershor, kur pritet edhe marrja e një vendimi". Ministri tha se reformat e bëra, veçanërisht ajo në drejtësi, krijoi besueshmëri të Komisioni Evropian. Duke folur për opozitën, Bushati tha se është për të ardhur keq që opozita ka vendosur bast kundër integritimit. "Nuk besoj se ka forca politike që e kundërshtojnë projektin evropian, por ka aktorë politikë që nuk kanë lënë gjë pa bërë për ta kundërshtuar zbatimin e reformës në drejtësi", - tha Bushati. Kreu i diplomacisë shqiptare theksoi se, "... vendimmarrja e BE-së nuk është as për qeverinë dhe as për Ramën". "Është për të ardhur keq që opozita shqiptare ka vendosur një bast dhe ka një ton ultimativ, a thua se në 28 qershor merr fund çdo gjë dhe në 29 qershor nuk lind më dielli në Shqipëri", - tha Bushati. Sipas tij, "... ky është një proces që prek të gjithë shqiptarët, ndaj është për të ardhur keq që opozita po përjashtohet nga kontributi që forcat politike kanë në këtë proces".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 101 / 8. E LLOJIT 'TRUALL + NDRËTESË', VOLUMI 8, FAJQE 115. ZONA KADASTRALE 3096, ME SIPËRFAQJE 3.200 M², NGA TË CILAT 166 M² ËSHTË NDRËTESA, NË ADRESËN : QERREKE-KRUJË, NË PRONËSI TË SHTETASË : Z. YAHIA FARWATI dhe BRIXHILDA FARWATI.

CMIMI 114.508 Euro . Data e zhvillimit të ankandit do jetë në datën 04.07.2018 . CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



Deputeti i PD-së: Në Shqipëri do vijë ish-luftëtarët e ISIS, që janë të papërshtatshëm për BE-në

Kampi te 'Ligjet', Manja: Kambanë paniku. Alibeaj: Pazar i pisët

PD: Refugjatët do të bien pre e kriminelëve

Valentina Madani

Opozita në Komisionin parlamentar të Ligjeve akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka vendosur që të ndërtojë në Shqipëri një kamp për refugjatët nga Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore. Deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj, duke iu referuar disa raporteve në mediat vendëse, por edhe të huaja për ngritjen e një kampi ku do të priten refugjatët të huaj, deklaroi se Rama po bën pazar me Shqipërinë e me shqiptarët. "Mediat jashtë edhe brenda vendit po thonë se ky njeri ka vendosur që këtë vend ta kthejë në kamp refugjatesh. Në një vend ku qindra mijëra ikin, siguria është zero. Po bën pazar të pista me Shqipërinë e me shqiptarët", u shpreh Alibeaj. Edhe deputeti tjetër i PD, Tritan Shehu akuzoi qeverinë dhe parajlmëritë se emigrantët do të krijojnë një korridor Durrës-Itali dhe një Otranto të mbushur me kufoma në det. Sipas tij, në Shqipëri është instaluar një diktaturë krimi. Shehu shtoi se projekti për të sjellë emigrantët nga Siria, që janë ish-luftëtarë të ISIS është e vërtetë. "Shqipëria po mbushet me kanabis dhe me krim, sot në Shqipëri po instalohet diktatura e krimi. Shteti vendosi krimin për të mbushur vendin me kanabis, pra re e tij dhe u dominua nga krimi. Është pengesa më e madhe në aspiratën tonë për në Evropë. Nuk është çështja për heqjen e një ministri, por heqja e një qeverie që është e lidhur me krimin. Kjo qeveri ka bërë mijëra qytetarë që të largohen nga vendi. Unë po them disa herë që është një diktaturë krimi, e them këtë dhe po e rithem, pasi është ka qenë vërtetë. Ka një projekt për të mbushur Shqipërinë me emigrantë, kjo është e vërtetë. E kanë thënë mediat e huaja shumë prestigjioze, do të vijë emigrantë ish-luftëtarë të ISIS, që janë të papërshtatshëm për Bashkimin Evropian", tha deputeti i PD-së. Por, kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja u përgjigj duke thënë: "Nuk më vjen mirë edhe për këtë kambanë paniku, këto çështje mund t'i ngrini te Komisioni i Jash-tëm". Deputeti demokrat,



Komisioni parlamentar i Ligjeve

AKSIONI OPOZITAR
PD mbledhi dje grupin parlamentar, ku të pranishëm ishin edhe aleatët. Deputetët diskutuan për aksionin politik. Ata do të jenë të pranishëm në të gjitha komisionet parlamentare dhe diskutimet do të përqendrohen në çështjen "Xhafaj". Këtë të enjte nuk do të ketë seancë plenare për shkak të mungesës së ligjeve.

Ekstremizmi i dhunshëm, masat e parandalimit

Këshilltari i Ramës: Nuk ka kamp të ISIS në Shqipëri

Këshilltari i kryeministrit Edi Rama për sigurinë, Sandër Lleshi, i ftuar dje në rubrikën "Opinion" në "News 24" foli për rrezikun e ekstremizmit të dhunshëm dhe çfarë masash po ndërmerret qeveria për parandalimin e tij. Lleshi tha se në vitin 2017 është ngritur qendra kundër ekstremizmit të dhunshëm, ku punojnë disa veta. "Aty punojnë disa veta për atë punë. Mbyllën një program trajnimi për mësuesit. Duam që qendra të bëhet rajonale", theksoi z.Lleshi. Përsa i përket lajmit për krijimin e kampit të ISIS në Shqipëri, këshilltari i Ramës tha se ishte totalisht i rremë. "Ne kemi krijuar module edukimi për besimin fetar në shkollë. Ekstremizmi dhe terrorizmi janë problemet më të



mëdha që ekzistojnë sot në botë. Të parandalojmë njerëzit të shkojnë atje në vendet e rrezikut, një halleluhi të marrë çantën e të nisat atje ku është ekstremizmi e radikalizmi, kjo është e para që duhet të bëjmë. Synimi është imuniteti i shoqërisë nga ekstremizmi. Sot janë 40-50 mln njerëz të gatshëm për të lëvizur nga vendet e tyre

QENDRA
Këshilltari i kryeministrit tha se në vitin 2017 është ngritur qendra kundër ekstremizmit të dhunshëm ku punojnë disa veta. "Aty punojnë disa veta për atë punë. Mbyllën një program trajnimi për mësuesit. Duam që qendra të bëhet rajonale", theksoi z.Lleshi.

dhe synimi është Europa. Nga viti 2012 ka pasur një fluks të madh, me linjën Turqi, Greqi, Kroaci, Austri e Europë, në Shqipëri nuk kanë kaluar. Populli duhet mbrojtur nga histeria kolektive apo paniku që mund të përfshihet. Emigracioni nuk rrezikon sigurinë kombëtare", u shpreh z.Lleshi.

pazar të pisët me Shqipërinë dhe shqiptarët. Për menderen e vet, për karrigen e vet. Prandaj axhenda e tij nuk është më si të ndërtojë shtetin, të bëjmë reformën në drejtësi, të japim prova elegjike që na i kërkojnë partnerët, të jepte prova që drejtësia vepron mbi Saimir Tahirin dhe mbi Patmirin. Jo. Alket vetëm ti mos fol, se ti ke edhe disa gjëra të tjera në këtë histori. Kjo është axhenda e kryeministrit që ka lënë çdo interes publik. Si taleban i vërtetë politik vazhdon të

mbrojtë veten e vet dhe karrigen e vet", deklaroi z.Alibeaj. Sipas tij, Rama po shet çdo gjë vetëm për karrigen e vet, teksa nuk la jashtë vëmendjes dhe Teatrin Kombëtar. "Dhe si qersh mbi tortë, i këput edhe një prishje Teatrit Kombëtar. Në gjithë këtë zallamahi të madhe, huqin e ka tek vjedhja. Prish Teatër për të vjedhur toka, për të mbjellë kulla", tha ai. Sipas Alibeaj, reforma në drejtësi u ka prerë krahët shqiptarëve për të gjetur drejtësi.

Strehimi i refugjatëve, Voda: Asnjë kërkesë zyrtare nga BE

Pak ditë më parë, në një shkrim të publikuar në "Le Monde", thuhej se Austria dhe Danimarka, por edhe vende të tjera po kristalizojnë idenë e tyre për ngritjen e kampeve për ata që kërkojnë azil në vendet e BE-së dhe atyre që u refuzohet kjo kërkesë, duke përfshirë në këtë shkrim si vende potenciale edhe Shqipërinë dhe Kosovën. "Deri në këto momente nuk kemi asnjë njoftim zyrtar nga vendet të BE-së për ngritjen e një qendre të tillë në Shqipëri. Pavarësisht numrit në rritje të emigrantëve të paligjshëm që kanë ardhur nga vendet e treta, kapacitetet tona deri tani e kanë përballuar këtë situatë", tha zv.ministria e Brendshme, Rovena Voda për "Klan".

"Xhafaj kapi veç një grup xixëllonjash"

Berisha: Bandat janë fuqizuar dhe bëjnë ligjin në çdo qytet

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje në "Face book" mesazhin e oficerit dixhital, ku ky i fundit denoncon ministrin Fatmir Xhafaj. Sipas Berishës, Xhafaj për muaj të tërë fliste për 40 banda, grupe kriminale, por kapi vetëm një grup 'xixëllonjash' të rrezikshme. Ndërkohë, oficeri dixhital shkruan se ministri "po i ngjan çdo ditë e më shumë Ali Babës. Propaganda e tij foli për 40 banda, por përveç një grupi prostitucioni në Shkodër, nuk kapi asnjë tjetër. Ndërkohë, bandat janë fuqizuar dhe bëjnë ligjin në çdo qytet të vendit! Tani është vetëqëndrohet po në numër 40". "Xhafaj i drogës me 40 hajdutë! Oficeri dixhital denoncon: Xhafajin e drogës, i cili për muaj të tërë fliste për 40 banda, grupe kriminale por, pasi me narko - taskforcën e tij kapi vetëm një grup xixëllonjash të rrezikshme, harroi 40 bandat famëzeza që bëjnë ligjin në mbarë vendin!", shprehet z.Berisha.

STRATI Shoqëria përbërëse "STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:
"Arë" me sipërfaqe 3000 m², e ndodhur në Tiranë, Kashar, regjistruar në pronësi të Eduard Zadeja, me Nr. Pasurive 1152/36, Zona Kadastrale Nr. 2105, volumni 17, fage 154, regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Tiranë, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 321 Rep dhe Nr. 125 Kol datë 12.02.2007. Cifra fillimtarë i ankandit është 246.900 Euro.
Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në orë 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbërëse "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Vijon procesi gjyqësor për bashkëpunëtorin Fatjon Karmeshtna

Porositi vrasjen e gruas, burg përjetë për Sadetin Sulën

Biznesmeni nga Shkodra "kyç" gojën në Gjykatën e Krimeve të Rënda

Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi ditën e djeshme me burgim të përjetshëm Sadetin Sulën, pasi akuzohet se porositi vrasjen e gruas së tij. Biznesmeni nga Shkodra, i cili ishte i pranishëm në seancë, nuk dha asnjë reagim pas vendimit të dhënë nga trupa gjyqësore. Ndërsa familjarët e Sadetin Sulës, të pranishëm në seancë gjyqësore kanë kundërshtuar vendimin duke hedhur akuza ndaj gjykatës. Ngjarja për të cilën akuzohet 47-vjeçari ndodhi në prill të 2016-ës, në mobilierinë e familjes, pasi kjo e fundit nuk i bindej. Biznesmeni i frikësohej divorcit për përgjysmimin e pasurisë dhe akuzonte bashkëshortin për tradhti. Pas gati dy vite hetimesh, prokuroria arriti të gjejë personin që kishte mbytur 38-



Sadeti Sula para gjykatësve

vjeçaren. Sipas hetimeve, ai ishte Fatjon Karmeshtna, punëtor i çiftit Sadetin dhe Suela Sula në mobilierinë e tyre në Bushat të Shkodrës, aty ku ka ndodhur krimi në prill të 2016-ës. Për këtë të fundit ka një proces gjyqësor, që po zhvillohet veçmas. Si fillim, ngjarja e rëndë u cilësua si vetëvrasje, më pas u zbulua se autori i krimit të rëndë ishte

Fatjon Karmeshtna. Ndërkohë, porositi i vrasjes ishte bashkëshorti i viktimës, Sadetin Sula. Është e provuar shkencërisht nga analizat e ADN-së, që Karmeshtna është ekzekutuesi i krimit duke mbytur viktimën me duar: Kampione të mbetjeve të marra nga thonjtë e Suelës janë krahasuar me ato që 35-vjeçari ka lënë në grykën e një shisheje

u. Gjithashtu, provë tjetër është edhe një regjistrim audio i bërë nga telefoni i viktimës. Në këtë material dëgjohej se si Sadetin Sula dhe i arrestuari flasin me njëri-tjetrin. Përgjimet e kryera para vrasjes nga vetë viktimja treguan se si Sadetin Sula dhe ish-punonjësi i tij planifikuan çdo gjë. Në një seancë gjyqësore para togave të zeza u publikuan disa përgjime ku 45-vjeçari fliste për magji ndaj viktimës dhe në një moment, Sadetini shprehej se më mirë e mbyste me duart e tij, sesa ta lejonte Suela Sulën t'i merrte gjysmën e pasurisë. Teksa i ankohej për faktin se gruaja nuk i nënshtrohej, Karmeshtna i shprehej Sadetinit se këtë punë do ta rregullonte ai. Fatjoni i shprehej se "do ta nënshtroj gruan tënde duke i bërë magji". Madje, ai i kërkoi para në këmbim që gruaja t'i nënshtrohej.



Vrau prindërit, dërgohet në psikiatri 26-vjeçari nga Dibra, Qemal Sela

Gjykata për Krime të Rënda ka caktuar ditën e djeshme masën "Shtirim i detyrueshëm në spital psikiatrik", për 26-vjeçarin Qemal Sela, i cili të enjten e 7 qershorit vrau me armë zjarri prindërit e tij. Sela do të shtrihet në spital psikiatrik, pasi dyshohet se ai vuan nga probleme mendore, ndërkohë që priten të dhënat edhe nga raporti mjekësor. Mësohet se gjatë seancës gjyqësore i riu nuk ka qenë i vetëdijshëm për të dhënë deklaratën e tij, ndërsa herë pas here fliste përçarët. Bëhet me dije se Sela do të dërgohet në spitalin e Shkodrës. "Nuk kam vrarë prindërit, por dy hije që u ngjanin mamit e babait. Ishin të maskuar dhe do më bënin vaksinë". Kështu mësohet të ketë thënë i riu para togave të zeza. I riu dyshohet se në Angli ka qenë i shtruar për tre muaj në një spital psikiatrik, para se të deportohej në Shqipëri. Pak ditë më parë 26-vjeçari Qemal Sela vrau prindërit Flamur Sela, 55 vjeç dhe Zeqimete Sela, 50 vjeçe. Ai i qëlloi për vdekje prindërit e tij, pranonarë të një hoteli të "Llixhat", në sy të klientëve. Dëshmitarë nga vendngjarja rrëfeyen tmerrin, duke thënë se i riu ka qëlluar fillimisht të atin dhe të dera e hotelit i ka marrë jetën edhe të ëmës. Ata pohuan se kanë parë tmerr me sy, teksa kanë parë gjithë ngjarjen kriminale.

Çështja u kalon Krimeve të Rënda

Vrasja e Fildez Hafizit, zgjidhet ngërçi për gjykimin e Fadil Kasemit

Gjykata e Lartë i ka dhënë zgjidhje ngërçit të çështjes së vrasjes së gjyqtarës Fildez Hafizi nga bashkëshorti i saj, Fadil Kasemi. Gjykata e Lartë ka vendosur që çështjen ta gjykojnë Krime të Rënda. Vendimi vjen pak ditë pasi emisioni "Studio e Hapur" në "News 24" e ngriti si shqetësim, duke marrë shkas edhe nga letra e babait të gjyqtarës së vrarë, të shkruar pak ditë para vdekjes, ku thoshte se ish-dhëndri ishte drejt lirimit për shkak të 'pingpongut' mes institucioneve të drejtësisë. Në letër, babai Bynjamin Hafizi kërkoi sensibilizimin e institucioneve. Ai ia ka drejtuar letërën Ilir Metës, Etilda Gjonajt, Xhezair Zaganjorit dhe ambasadorëve Donald Lu e Romana Vlahutin. Kjo çështje prej rreth një viti po shqetësoi në Gjykatën e Krimeve të Rënda, në atë të Shkallës së Parë të Tiranës, pa mundur dot të shqyrtohej. Më 30 maj, Gjykata e Tiranës ia përcollti dosjen Gjykatës së Lartë, pasi ishte e paqartë mbi kompetencën për shqyrtimin e çështjes. Por,



VRASJA

Gjyqtarja Fildez Hafizi u vra më 31 gusht 2017 nga ish-bashkëshorti i saj, 39-vjeçarja u qëllua me 2 plumba pistolette brenda makinës së saj nga Fadil Kasemi. Ky duket se ishte fundi i një kronike të paralajmëruar, pasi kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara.

të njëjtin problem më parë e kishte konstatuar edhe Gjykata e Krimeve të Rënda, e cila e kishte transferuar çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë, pas një vendimi të Gjykatës së Lartë.

Gjyqtarja Fildez Hafizi u vra më 31 gusht 2017 nga ish-bashkëshorti i saj, 39-vjeçarja u qëllua me 2 plumba pistolette brenda makinës së saj nga Fadil Kasemi. Ky duket se ishte fundi i një kronike të paralajmëruar, pasi

kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara. Shkak për këtë situatë ishte divorci mes Hafizit dhe Kasemit. Edhe pse kishte marrë një urdhër mbrojtje, gjyqtarja merre kërcënime të vazhdueshme nga ish-bashkëshorti. Por duket se saga fatkeqe e familjes së gjyqtarës së ndërjerë nuk mbaroi me kaq. Për shkak të ngërçit me reformën në drejtësi, nuk është shqyrtuar ende çështja e Fadil Kasemit.



BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



Te gjitha te rejat nga jeta vipave

çdo të shtunë falas me

GAZETA SHQIPTARE

Avokati, Sokol Hazizaj: Ligji fitoi dhe reforma në drejtësi dha suksesin e parë

Ina Allkanjari

Adriatik Llalla i shpëton vetingut, Kolegji i Apelit: Dorëheqja, konform ligjit

"Do të qëndrojë 15 vjet jashtë sistemit të drejtësisë"

Kolegji i Posaçëm i Apelit me shumicë votash vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për Adriatik Llallën. Ky ishte vendimi i marrë nga KPA ditën e djeshme, ndaj ish-prokurorit të përgjithshëm, pas ankimit të bërë nga Komisioneri Publik, i cili kundërshtonte ndërprerjen e vetingut për Adriatik Llallën. KPA e cilësoi të drejtë vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë mënyrë merr fund rrugëtimi i Llallës në sistemin e drejtësisë, larg të cilit duhet të qëndrojë për 15 vjetet e ardhshme. "Janë përbushur elementet e dorëheqjes nga detyra, pasi është zbatuar një prej rrugëve procedurale të legjislativimit në fuqi. Kolegji çmon se vendimarrja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka qenë e drejtë dhe duhet konfirmuar. Kolegji me shumicë votash vendosi ndryshimin e vendimit: ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për Adriatik Llallën. Ndalimin e emërimit të tij, gjyqtar, prokuror apo anëtar i KLD-së për një periudhë prej 15 vitesh", thuhet ndër të tjera në vendimin e KPA. Konkretisht trupa gjyqësore kryesohet nga Sokol Çomo, relator Luan Daci, anëtarë Albana Shtylla, Artan Hajdari dhe ish-kryeprokurorja Ina Rama. Me shumicë, vendosën 5 kundër kërkesës së Komisionerit Publik, dhe pro kërkesës së Llallës duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit datë 16 shkurt 2018 për ndërprerjen e vetingut. Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla nuk mori pjesë në dy seancat e kaluara si dhe në seancën e djeshme, ndërsa u përfaqësua nga avokati Sokol Hazizaj. Mbrojtësi i Llallës tha se me vendimin e KPA ka fituar ligji dhe se reforma në drejtësi dha suksesin e pare. Sipas tij Llalla



Artan Hajdari, Albana Shtylla, Sokol Çomo, Luan Daci, Ina Rama, gjatë një seance të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, KPA



Ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla

ka zbatuar procedurat ligjore për dorëheqjen dhe se nuk ka informacion zyrtar nëse ndaj tij do ketë hetim penal. "Ligji fitoi dhe reforma në drejtësi dha suksesin e parë. KPA dha vendimin e drejtë për Adriatik Llallën, i cili zbatoi procedurat ligjore për dorëheqjen. Për hetimin penal nuk kam informacion zyrtar, ndërsa për vendndodhjen e Llallës nuk mund të flas", ka thënë Sokol Hazizaj. Kujtojmë se në seancën e shkuar Komisioneri Publik, Florian Ballhysa tha se Adriatik Llalla si magjistrat nuk ka ndjekur procedurën ligjore të dorëheqjes. Ballhysa tha se megjithëse Llalla ka lënë detyrën në dhjetorin e vitit të kaluar, ai nuk është larguar si magjistrat dhe si i tillë duhet të kalojë në filtrat e verifikimit të pasurisë dhe figurës. "Llalla e

gëzon ende statusin e magjistratit për shkak se është ish-kryeprokuror. Ai nuk e ka dhënë dorëheqjen në formën e kërkuar", tha Ballhysa. Por pas vendimit të Kolegjit, çështja 'Llalla' mund të konsiderohet një kapitull i mbyllur në institucionet e shtetit shqiptar. Gjykata e Strasburgut është hallka e fundit, ku mund të trokaset Komisioneri Publik, nëse nuk është dakord me shkallën e dytë të vetingut.

PËRPLASJA LLALLA-LU

Ndërkohë kujtojmë se Adriatik Llalla po hetohet nga prokuroria e Krimeve e Rënda për disa vepra penale; "Refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave private të zgjedhur dhe nëpunësve

Avokati
"Ligji fitoi dhe reforma në drejtësi dha suksesin e parë. KPA dha vendimin e drejtë për Adriatik Llallën, i cili zbatoi procedurat ligjore për dorëheqjen. Për hetimin penal nuk kam informacion zyrtar, ndërsa për vendndodhjen e Llallës nuk mund të flas", - ka thënë avokati Sokol Hazizaj.

publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor

për deklarim", "Mosdeklarimit të shumave të të hollave në kufi", "Pastrimit të produkteve të veprës penale" dhe "Shpërdorimit të detyrës". Në vitin e fundit të mandatit të tij, Llalla pati konflikt të hapur me ambasadorin e SHBA në Tiranë Donald Lu. Konkretisht akuzat e pastrimit të parave, e cila rëndon mbi Llallën, u paralajmërua nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Prej kohësh ambasadori amerikan Donald Lu ka mbajtur një qëndrim të ashpër dhe kritikues ndaj Adriatik Llallës, të cilin e ka akuzuar publikisht si personi që ka dashur të pengojë reformën në drejtësi. Por akuzat kaluan në një tjetër nivel dhe nuk mbetën në vetëm në kuadrin e personit anti-reformë. Ato u formësuan pas vendimit të Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili e shpalli non grata Adriatik Llallën, si person i përfshirë në afëra të mëdha korruptive. Përplasjet vijuan pas publikimit të letërës që Adriatik

VENDIMI
"Janë përbushur elementet e dorëheqjes nga detyra, pasi është zbatuar një prej rrugëve procedurale të legjislativimit në fuqi. Kolegji vendosi ndryshimin e vendimit: ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për Adriatik Llallën. Ndalimin e emërimit të tij, gjyqtar, prokuror apo anëtar i KLD-së për një periudhë prej 15 vitesh", - thuhet në vendimin e KPA.

Llalla, gjatë kohës kur ishte kryeprokuror i kishte drejtuar Kongresit Amerikan. Ndër të tjera ai akuzonte ambasadorin Lu se i kishte kërkuar nominalisht, arrestimin e Ilir Metës. I menjëhershëm ishte dhe reagimi i ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në Tiranë, i cili i cilësoi si gënjeshtër këto pretendime me argumentin se Adriatik Llalla i trembet arrestimit për korrupsion. Por debati Llalla-Lu nuk u mbyll me kaq. Me anë të një deklarate për mediat, ish-kryeprokurori lëshoi serish akuzat ndaj diplomatit amerikan, duke u shprehur se ai ka marrë rolin e prokurorit, gjykatësit dhe të juristit, duke e shpallur atë si fajtor për korrupsion, në kohën kur, sipas vetë Llallës, ndaj tij nuk ka asnjë provë. Llalla kërkoi nga Lu që të heqë dorë menjëherë nga abuzimi me pushtetin dhe ndërhyrjen në punët e sistemit të drejtësisë shqiptare.

Lëvizje në Tiranë e disa qarqe, lufta ndaj krimit e drogës

Ndryshime në Policinë e Shtetit, emrat e drejtuesve të rinj në disa komisariate

Vijojnë lëvizjet në Policinë e Shtetit në kuadrin të intensifikimit të luftës ndaj krimit e drogës. Mësohet se kryekomisarar Pal Marku, me detyrë Specialist në Njësinë për Hetimin e Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë në Drejtorinë Hetimore Qendrore në Departamentin e Policisë së Shtetit, është caktuar përkohësisht në detyrën shëf i Komisarariatit të Policisë Nr.6. Ndërkohë, komisar Gilbert Hoxha, me detyrë shëf Sektori, në

NDRYSHIMET
Përpos Tiranës, ndryshime janë firmosur nga drejtori i përgjithshëm edhe në qarqe në nivel zv.drejtorësh. Hamdi Fiora emërohet zv.drejtor në Korçë, Arjan Ferri në Berat, Erzen Cera në Dibër, Skënder Hita në Shkodër, Adriatik Tavciu në Lezhë, Koço Dafa në Gjirokastrë dhe Ervin Ndreu nga shëf komisarariatit në Krutje është emëruar zv.drejtor në Durrës në vendin e Bajram Marës.

Sektorin për Hetimin e Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë është caktuar përkohësisht në detyrën Shëf i Komisarariatit të Policisë Nr.2. Bëhet e ditur se nënkomis-

ar Neritan Boçi, me detyrë shëf i Komisarariatit të Policisë Nr.6, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, është emëruar në detyrën Specialist në Seksionin për Hetimin e Krimeve ndaj Jetës dhe Pronës, në Drej-



torinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërkohë që përpos Tiranës ndryshime janë firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm edhe në qarqe në nivel zv/ drejtorësh. Hamdi Fiora emërohet zv/drejtor në Korçë, Arjan Ferri në Berat, Erzen Cera në Dibër, Skënder Hita në Shkodër, Adriatik Tavciu në Lezhë, Koço Dafa në Gjirokastrë dhe Ervin Ndreu nga shëf komisarariatit në Krutje është emëruar zv/drejtor në Durrës në vendin e Bajram Marës.

LËVIZJET NË POLICINË E SHTETIT

◆ Emërimet

1. Gilbert Hoxha- shëf i Komisarariatit Nr. 2 në Tiranë
2. Pal Marku - shëf i Komisarariatit Nr. 6 në Tiranë
3. Neritan Boçi -nga shëf te Komisarariatit Nr. 6 emërohet specialist

◆ Emërimet në nivel zv/ drejtorësh

- | | |
|--------------------|----------------|
| 1. Hamdi Fiora | në Korçë |
| 2. Arjan Ferri | në Berat |
| 3. Erzen Cera | në Dibër |
| 4. Skënder Hita | në Shkodër |
| 5. Adriatik Tavciu | në Lezhë |
| 6. Koço Dafa | në Gjirokastrë |
| 7. Ervin Ndreu | në Durrës |

VRASJA E SHQIPTARIT



Vritet në Londër 35-vjeçari shqiptar, policia britanike kërkon ndihmë për identifikimin e autorëve

LONDËR - Një shqiptar ka humbur jetën mbremjen e së shtunës në Londër, pasi është goditur me thikë nga persona ende të paidentifikuar. Viktima është Edmond Jonuzi, 35 vjeç. Ngjarja ka ndodhur pranë stacionit të

metrosë Turnpike Lane, në veri të Londrës, raporton 'Daily Mail'. Shqiptari ka humbur jetën në vendngjarje pa pasur mundësi të transportohet në spital. Mësohet se ai është goditur disa herë me thikë në pjesë të ndryshme të trupit.

Dyshohet se vrasja ka ardhur pas një shërri mes dy grupeve në zonën e Ducketts Common. Për momentin nuk ka persona të arrestuar për vrasjen, ndërsa policia britanike ka kërkuar ndihmën e qytetarëve për identifikimin

dhe kapjen e autorëve. "Kjo është një zonë e populluar, shumë pranë stacionit të metrosë Tube Turnpike Lane. Do të ketë njerëz që panë ose dëgjuan diçka të dyshimtë që mund të na ndihmojnë të gjejmë kush e vrau shqiptarin. Unë po bëj thirrje për ndonjë dëshmitar apo kujtdo që ka informacion që të kontaktoj me policinë", tha inspektori i Komandës së Policisë Metropolitane.

Mediat italiane: Viktima dyshohet se ishte punonjëse seksi

ITALI

Një 20-vjeçare shqiptare është vrarë barbarisht në Itali. Bëhet fjalë për Anxhela Meçani, e cila është dhunuar barbarisht dhe më pas është hedhur nga një makinë. E reja ka humbur jetë sapo ka mbërritur në spital. Ngjarja e rëndë ka ndodhur rreth orës 20:00 të së dielës në Torino të Italisë. 'Republica' raporton se Anxhela Meçani ndërroi jetë në spitalin Santa Croce në Moncalieri. Mediat italiane raportojnë se vajza shqiptare, e cila dyshohet se ishte punonjëse seksi, është dhunuar deri në vdekje dhe më pas hedhur nga dritarja e një makine, e cila ishte në ecje. Për pasojë, ajo ka mbetur e plagosur rëndë, ndërsa nuk ka mundur t'u mbijetojë plagëve të marra. Ndërkaq, mediat e vendit fqinj, dje kanë publikuar edhe dëshmitë e para për ngjarjen e rëndë.

Ka qenë dëshmia e një tjetër drejtuesi mjetei ajo që ka alarmuar policinë italiane. Ai është shprehur se ka parë të hidhet një person nga një makinë. "Dikush hodhi një person nga makina e tij dhe u arratis", ka thënë dëshmitari. Kaq ka mjaftuar që policia italiane të shkojë në vendngjarje dhe të gjejë vajzën e re, shqiptaren Anxhela Meçani në gjendje të rëndë shëndetësore dhe me plagë në gjithë trupin. Ajo është transportuar menjëherë në spitalin Santa Croce në Moncalieri të Torinos ku dhe ka ndëruar jetë.

Dhunohet barbarisht dhe hidhet nga makina, vdes në spital 20-vjeçarja

Anxhela Meçani u hodh kur mjetei ishte në lëvizje



HETIMI

'Republica' raporton se Anxhela Meçani ndërroi jetë në spitalin Santa Croce në Moncalieri. Sipas mediave të vendit fqinj, vajza shqiptare, e cila dyshohet se ishte punonjëse seksi, është dhunuar deri në vdekje dhe më pas hedhur nga dritarja e një makine, e cila ishte në ecje. Për pasojë, ajo ka mbetur e plagosur rëndë, ndërsa nuk ka mundur t'u mbijetojë plagëve të marra. Pikërisht në këtë pistë po hetohet edhe nga policia.

Hetuesit ndër të tjera po mundohen të rindërtojnë të gjithë ngjarjen, se në çfarë vendi mund të ketë hipur ajo në makinë. Ata shpresojnë që duke identifikuar makinën nëpërmjet pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, të mund të identifikojnë dhe autorin/ët e krimit makabër.

DËSHMITARI

Mediat e vendit fqinj, dje kanë publikuar edhe dëshmitë e para për ngjarjen e rëndë. Ka qenë dëshmia e një tjetër drejtuesi mjetei ajo që ka alarmuar policinë italiane. Ai është shprehur se ka parë të hidhet një person nga një makinë. "Dikush hodhi një person nga makina e tij dhe u arratis", ka thënë dëshmitari. Kaq ka mjaftuar që policia italiane të shkojë në vendngjarje dhe të gjejë vajzën e re, shqiptaren Anxhela Meçani në gjendje të rëndë shëndetësore dhe me plagë në gjithë trupin. Ajo është transportuar menjëherë në spitalin Santa Croce në Moncalieri të Torinos ku dhe ka ndëruar jetë.

Makina përplas çiftin, humb jetën bashkëshorti, në gjendje të rëndë gruaja



të aksidentuar çiftin Beci. 49-vjeçari ia ka dalë që të ecë rreth 500 metër, por më pas edhe vetë është aksidentuar. Ai ka humbur kontrollin e fuoristradës dhe për pasojë

ka dalë nga rruga. Mjetei ka dëmtuar edhe bordurat dhe mbrojtëset e varrezave Komane në Shkodër. Ndërkaq, blutë kanë shkuar shpejt në vendngjarje dhe kanë nisur

hetimet, ndërsa kanë ndaluar 49-vjeçarin. Aksi nacional Shkodër-Hani Hotit vijon që të mos ketë ndriçim në asnjë pjesë. Edhe pse pothuajse e gjithë ajo rruga është një zonë e banuar në dy anë e saj me një numër të konsiderueshëm banesash dhe subjektsh tjera, ai segment qëndron gjatë gjithë kohës në errësirë. Edhe pse disa herë është kërkuar nga banorët dhe drejtuesit e mjeteve që të mundësohet ndriçimi për të shmangur këto aksidente fatale, ende një gjë e tillë nuk ka ndodhur.



Përplasje mes bandave shqiptare, vdes një grua e plagosur 4 të tjerë

BELGJIKË - Përplasje e dhunshme mes bandave rivale shqiptare në qytetin Ans në Belgjikë ka shkakuar vdekjen e një gruaje 43-vjeçare si dhe plagosjen e katër personave të tjerë. Sipas mediave belge, në konflikt u përdorën thika, shkopinj bejsbolli, shufra hekuri dhe sende të tjera të forta. Një grua 43-vjeçare humbi jetën duke u përpjekur të ndihmonte mikun e saj që kishte pësuar lëndime nga goditjet. Ajo u përplas nga një automjet i bandës rivale, duke i shkakuar asaj vdekjen. Sipas dëshmitarëve, bandat shqiptare kanë përplasur makinat me njëri-tjetrin dhe kanë hipur në trotuar duke aksidentuar njerëzit që po ecnin aty. Personat e plagosur janë transportuar në spital dhe janë në gjendje kritike për jetën. Disa nga personat që kanë marrë pjesë në sherr janë identifikuar por ende asnjëri prej tyre nuk është arrestuar. Policia po heton për ngjarjen dhe kapjen e autorëve.

Drogë me autobus drejt Greqisë, përfundon në pranga 24-vjeçari

GREQI - Një 24-vjeçar grek është ndaluar nga policia, pasi gjatë kontrollit i është gjetur dhe sekuestruar një çantë me lëndë narkotike. Mësohet se i riu po udhëtonte drejt Greqisë me autobusin e linjës Qafë Botë-Igumenicë. Sipas policisë së vendit fqinj, nga kontrolli i ushtruar në autobus dhe konkretisht në çantën e të riut u sekuestruan 3 pako me 3 kg 132 gr marijuanë.

Gjykata lë në burg 42-vjeçarin, rrezikon dënimin me burgim të përjetshëm

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Lqetë dhe pa asnjë shenjë pendese në fytyrë ka hyrë dje në sallën e gjyqit Çlirim Shaholli, i cili mbrëmjen e së premtes së shkoj vrau në mënyrë makabre gruan e tij, nënë e 6 fëmijëve. I braktisur nga të afërmit, 42-vjeçari ka deklaruar para trupit gjykues se ka debatuar ashpër me gruan për motive xhelozie dhe më pas janë përleshur në banesë. "Po, unë e vrava gruan. E shtyva dhe ia përplasa disa herë kokën në dys-heme", është shprehur autori i krimit në familje, që tronditi banorët e qytetit të Durrësit dhe jo vetëm. I ftohtë në rrëfimin e tij, Çlirim Shaholli nuk u ka kërkuar ndjesë as fëmijëve të tij për krimin e kryer. Ndërkohë, trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtarja Eda Kaja ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 42-vjeçarit për veprën penale: "Vrasje me dashje në rrethana cilësuese për arsye familjare". Shaholli rrezikon dënimin nga 20 vite burg deri në burgim të përjetshëm.

GJYQI

Rreth orës 15:00 të ditës së djeshme, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Durrësit u zhvillua seanca gjyqësore për vendosjen e masës së sigurisë ndaj Çlirim Shahollit. Në seancën e cila u zhvillua me dyer të mbyllura dhe që zgjati vetëm 10 minuta nuk ishte i pranishëm asnjë familjar i 42-vjeçarit, i cili goditi për vdekje gruan e tij, Ardiana Shaholli. Ndërsa, i pandehuri u përfaqësua nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata. Mësohet se prokurorja e çështjes, Rabjana Halili ka kërkuar lënie në qeli të autorit. Kërkesa e saj është pranuar nga togat e zeza të qytetit bregdetar, të cilët e kanë konsideruar të ligjshëm ar-

Çlirim Shaholli nuk njih pendesë: E vrava gruan, pasi dyshoja se më tradhtonte me pronarin

"U përleshëm në banesë, e shtyva dhe ia përplasa kokën disa herë në dys-heme"



40-vjeçarja e vrapë, Ardiana Shaholli



I arrestuari Çlirim Shaholli në gjykatën e Durrësit

VRASJA

Rreth orës 19:55 të datës 8 qershor, krimi në familje tronditi Durrësin. Pas një sherri, Çlirim Shaholli goditi për vdekje bashkëshorten Ardiana Shaholli, nënë e 6 fëmijëve. Ngjarja e rëndë ndodhi në lagjen nr.15 të këtij qyteti. 40-vjeçarja u dërgua në urgjencën e spitalit të qytetit bregdetar nga i shoqi, i cili më pas u arrestua nga policia. Viktima dha shpirt në spital për shkak të goditjeve që kishte marrë në kokë.

DËSHMIA E VRASËSIT NË POLICI

Pas arrestimit, Çlirim Shaholli deklaroi gjatë marrjes në pyetje në polici se nuk dëshironte ta vriste gruan e tij. "Nuk doja ta vrisja gruan. Nuk e besoj se ajo ka vdekur. Është gjë shumë e rëndë për familjen tonë dhe për fëmijët tanë të mitur. Ne u zëmë. Ajo më shtyva dhe unë e shtyva. Nuk e mbaj mend mirë se si nisi sherri, por më duket se u grindëm për derën, jo hape ti, jo hape ti, pasi ishte shumë vapë. Fëmijët nuk ishin në banesë, pasi po luanin jashtë. Mbaj mend se e shtyva dhe ajo ra me kokë në çimento. E mora në krahë dhe e çova në spital", ka thënë 42-vjeçari. Ndërsa, dje autori i krimit ka dhënë tjetër version.

restimin e Shahollit. Ndërkaq, autori i krimit ka pranuar vrasjen, ndërsa ka treguar me detaje se si nisi sherri me viktimiten dhe fundin e saj tragjik.

RRËFIMI I VRASËSIT NË GJYKATË

"Kemi ardhur nga Maliqi i Korçës dhe prej vitesh banojmë në lagjen nr.15 të qytetit të Durrësit. Mbrëmjen e së

FËMIJËT E ÇIFTIT SHAHOLLI

Familja Shaholli jetonte në varfëri ekstreme, më shumë pa bukë se me bukë. E gjithë familja mbahej vetëm me rrogën e nënës së 6 fëmijëve, e cila punonte në një lavanderi. Pas krimit në familje, 6 fëmijët e çiftit kanë mbetur jetimë. Tre fëmijët më të mëdhenj (djali më i madh është 18 vjeç), jetojnë në banesën e tyre. Ndërsa, tre fëmijët e vegjël (më e vogla 8 vjeçe) janë marrë nga një shoqatë dhe janë dërguar në një kamp veror. Askush nga të afërmit nuk e dinë se çfarë do të bëhet me 6 fëmijët e çiftit Shaholli.

premtes, kur ndodhi ngjarja, unë dhe gruaja ime, Ardiana debatua shumë me njëri-tjetrin. Sherri nisi se unë jam xheloz dhe dyshoja se ajo më tradhtonte me pronarin e

firmës ku punonte. I thashë gruas pse shkon në punë, apo ke zënë dashnor pronarin. Mos shko më, pasi nuk pse shkon në punë. Ndërsa, ajo më tha: "Ngruhi dhe puno ti

dhe ruaj kalamajtë e mos rri kot në shtëpi. Si mund të më thuash se paskam zënë dashnor në punë. Aty punojnë dhe 20 vajza të reja dhe kush mund të më hedhë sytë mua". Pas kësaj, ne u përleshëm. Unë shtyva dhe ia përplasa kokën disa herë në dys-heme.

VENDIMI

Pas dëshmisë së dhënë nga i pandehuri Çlirim Shaholli, trupi gjykues ka vendosur lënie e tij në qeli. Mësohet se avokatit mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata nuk ka kërkuar masë lehtësuese për klientin e tij. Ai është shprehur në sallën e gjyqit: "Çmuj që gjykata të japë vendimin për klientin tim".

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: -- ITB- Procurement of Central Infrastructure for OSSH Service Delivery in Albanian LGUs

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 47098**

ITB- Procurement of Central Infrastructure for OSSH Service Delivery in Albanian LGUs
For more details please refer to the link below:

<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **03 July 2018**

Address for communications:

Email: procurement.al@undp.org

Or

Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

Dhunoj me sende të forta në kokë nënën e moshuar, përfundon në pranga 51-vjeçari

GRAMSH - Një 51-vjeçar nga Gramshi ka përfunduar në pranga e policisë, pasi ushtronte dhunë sistematike ndaj nënës së tij të moshuar. Ngjarja në fjalë ka ndodhur në fshatin Muçaj të këtij rrethi. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për Vait Muçen, i cili akuzohet se ka goditur me sende të forta në kokë nënën 76-vjeçare. Mësohet se e moshuara është dërguar urgjentisht në spitalin e Gramshit, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. "Shtetasi i lartpërmendur, në banesë, për motive të dobëta ka ushtruar dhunë fizike në



mënyrë të vazhdueshme duke e goditur me sende të forta në kokë nënën e tij, shtetasen H.M.76 vjeçe, e cila është transportuar në spitalin e Gramshit, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ma-

teriallet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprën penale "Dhuna në Familje", thuhet në komunikatën zyrtare të policisë së Elbasanit.

Të dhënat e INSTAT, papunësia në nivelin më të ulët historik, 12.5%

Ahmetaj: Punësimi është rritur me 4.9 për qind

Ministri: Thyem një rekord historik, por jemi larg ambicies

PUNESIMI

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj në një konferencë për shtyp deklaroi se punësimi ka vijuar trend rritës, ndërsa pohoi se ky është një lajm i mirë. Uljen e shifrave të papunësisë Ahmetaj cilësoi rekord historik. Ministri tha se punësimi për tremujorin e fundit është rritur 4.9 për qind.

Ornela Manjani

Ulet numri i të papunëve në Shqipëri. Të dhënat e INSTAT nxjerrin në pah se niveli i papunësisë për tre muajt e parë të 2018 arrin në 12.5% nga 13.4% që ishte në tremujorin e fundit të 2017. Shkalla zyrtare e papunësisë për burrat mbetet më e lartë dhe është 12,6 % ndërsa për gratë është 12,3 %. Në një konferencë për mediat ministri i Financave u shpreh se pavarësisht shifrave pozitive ende duhet të punohet për të rritur punësimin. Sipas Ahmetaj në pesë-mujorin e parë 2018, ose në periudhën janar-maj, janë shpallur 26,543 vende të lira pune.

MINISTRI

Ministri i Financave Arben Ahmetaj në një konferencë për shtyp deklaroi se punësimi ka vijuar trend rritës, ndërsa pohoi se ky është një lajm i mirë. Ulja e shifrave të papunësisë Ahmetaj e cilësoi rekord historik. Ministri tha se punësimi për tremujorin e fundit është rritur 4.9 përqind. "Është publikuar nga INSTAT dhe është konfirmuar trendi rritës i punësimit. Lajmi tjetër shumë i mirë është ulja e papunësisë në nivelin më të ulët historik, një 12.5 %, është një ulje për të gjithë vitet e tranzicionit. Shqipëria mbetet me normën më të ulët të papunësisë tek rinia. Por a është e mjaftueshme, kjo? E rëndësishme është që jemi në trend zbritës dhe jemi me nivelin më të ulët në rajon. Dua të sjell në vëmendje se në këtë vit janë shpallur mijëra vende të reja pune, dhe vetëm në maj janë realizuar më shumë se 3 mijë punësime, me bashkëpunim shtet-privat", tha Ahmetaj. Ministri i Ekonomisë dhe Financave iu referua edhe raporteve të institucioneve ndërkombëtare në lidhje me punësimin. "Sigurë vlerëson edhe raporti i fundit i Bankës Botërore, Shqipëria është vendi i parë në rajon për sa i përket punësimit të forcës së aftë për punë. Pjesëmarrja në forcën e punës ka arritur në 59.2%, 51.9 tek gratë dhe 66.5% tek burrat. Për publikum kam sjell edhe një grafik të kombinuar, për të treguar uljen historike të papunësisë në 27 vitet e fundit dhe sigurisht pjesëmarrjen në forcën e punës. Po kështu Shqipëria mbetet vendi me normën më të ulët të papunësisë tek të rinjtë dhe shifra vjetore vazhdon të zbrisë, sigurisht që debati në publik, në shoqërinë, apo edhe në parlament është dhe normalisht duhet të ishte e të jetë: A është e mjaftueshme? A është e mjaftueshme kjo ulje e papunë-



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

VENDE TË LIRA

Në pesë-mujorin e vitit 2018, pra janar-maj janë shpallur 26 mijë e 543 vende të lira pune dhe vetëm në muajin maj janë shpallur 8 mijë e 442 vende të lira pune. Ndërkohë që janë realizuar 11 mijë e 88 punësime, pra ndërmjetësime nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në pesë-mujor dhe vetëm në muajin maj janë realizuar 3 mijë e 439 punësime me ndërmjetësim.

sisë. A është i mjaftueshëm krijimi i të gjithë atyre vendeve të reja të punës? Sigurisht që, jemi larg asaj që kemi si ambicie, por është e rëndësishme të ndalojmë për një sekondë të vetme dhe të shënojmë që jemi në nivelin më të ulët historik të

papunësisë në Republikën e Shqipërisë. Ajo që vazhdon të vijojë dhe ulja e papunësisë tek të rinjtë është në zbritje dhe është më e ulta në rajon me nivelin 24.5%", deklaroi Ahmetaj. **VENDET E REJA** Sipas ministrit të Finan-

cave në pesë muajt e parë të vitit janë shpallur mbi 26 mijë vende të reja pune. "Dua t'iu sjell në vëmendje, është se në pesë muajorin e vitit 2018, pra janar-maj, janë shpallur 26 mijë e 543 vende të lira pune dhe vetëm në muajin maj, janë shpallur 8

PD kundër Ahmetajt, Paloka: 400 mijë shqiptarë janë larguar

Deputeti i PD, Edi Paloka ka reaguar pas deklaratës së ministrit të Financave, Arben Ahmetaj se punësimi ka vijuar trend rritës dhe ka ulje të shifrave të papunësisë. Përmes një postimi në 'Facebook', Paloka thotë se qeveria ka detyruar 400 mijë shqiptarë të largohen nga vendi. "Qeveri palaçosh; kanë detyruar mbi 400 mijë shqiptarë të largohen nga vendi dhe deklarojnë me paturpësi se është ulur përqindja e të papunëve. Në fakt, vendet e punës janë ulur; është rritur numri i shqiptarëve të mbetur papunë që largohen nga vendi dhe palaçot këtë paraqesin si "sukses", si ulje të numrit të të papunëve në vend", -shkruan Paloka.



mijë e 442 vende të lira pune. Ndërkohë që janë realizuar 11 mijë e 88 punësime, pra ndërmjetësime nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në pesë muajor dhe vetëm në muajin maj janë realizuar 3 mijë e 439 punësime me ndërmjetësim. Në të njëjtën

kohë dua të theksoj politikat tona fiskale, sikurse e kemi bërë për publikun prezent, vijojmë të mbështesim lehtësimin e sipërmarrjes dhe garantimin e rritjes së qëndrueshme që më në fund prodhon punësim", -tha Ahmetaj.

Nis riparimi në Tiranë-Durrës

Gjikhuri: Përfundon brenda qershorit, ndërhyrje edhe në rrugë të tjera

Ka nisur këtë të hënë kështu sikurse ishte paralajmëruar ndërhyrja në autostradën Tiranë-Durrës për të kryer riparimet në shtresën e asfaltit të rrugës. Ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë Damian Gjikhuri dhe Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar Afrim Qendro ndoqën nga afër punimet duke deklaruar se ato përfundojnë brenda qershorit. "Brenda qershorit përfundoje punimet në këtë rrugë. Synohet që të përmirësohet si pjesa e sigurisë ashtu edhe sinjalistikës dhe kalueshmërisë. Duhet të kuptojmë që ky nuk është një rehabilitim. Ne e bëme gati projektin e rehabilitimit, por Banka Botërore nuk e miratoi. ARRSH po përpunon sërish dhe po mundohemi që të gjejmë fondet" tha Qendro. Ministri Gjikhuri nga ana tjetër u shpreh se kontra-



ta e mirëmbajtjes e dakordësuar me Bankën Botërore që përfshin 1335 kilometra rrugë në gjithë vendin ka pasur probleme të trashëguara dhe gjatë këtyre muajve fokusi ka qenë tek zgjidhja e ngërçeve kontraktuale që po çonin këtë proces në dështim. "Jemi në fazën kur ka kaluar kjo pjesë dhe ky projekt do funksionojë në mënyrë intensive. Në vijim në gjithë akset kryesorë që janë pjesë e kësaj kontrate do të ketë ndërhyrje serioze sa i përket mirë-

mbajtjes normale. Dua që të na mirëkuptojnë qytetarët pasi jemi të ndërgjegjshëm që do krijohen probleme me trafikun, por ndërhyrjet janë të domosdoshme. Janë marrë masa që të punohet 24 orë dhe që brenda qershorit kjo rrugë të jetë tërësisht e riparuar dhe e hapur për trafikun. Qytetarët që duan të shkojnë në Jug të marrin rrugën e Elbasanit dhe të shkojnë nga Rrogozhina kurse pjesa tjetër të ndjekin udhëzimet", - tha Gjikhuri. Të shtunën e kaluar ARRSH

Autostradën e mbyllën, po 10 milionë turistët do kalojnë nga malet si kaçakë?

Kreuar grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili ka reaguar lidhur me projektin e rehabilitimit të autostradës Tiranë-Durrës, që sollë edhe bllokimin e saj. Përmes një statusi në "Facebook" Vasili tekta bën një pyetje, sulmon qeverinë, për faktin se nga do të kalojnë turistët që vijnë në Shqipëri. Sipas Vasilit autostrada u mbyll nga 'strategët' e turizmit në startin e sezonit. "Thonë që priten 10 milionë turistë në Shqipëri këtë vit. Autostradën Tiranë-Durrës e mbyllën këta "strategët" e turizmit pikërisht në startin e sezonit turistik. E padëgjuar kjo bëmë e fundit e këtyre. Po këta 10 milionë turistët nga do t'i bien për të dalë në det? Nga kodrat e nga malet i bie, se rrugë tjetër nuk ka. Po mijëra shqiptarëve që duan edhe ata të bëjnë pushime pse ia nxijnë jetën xhanëm?" -shkruan Vasili.

dhe Policia e Shtetit deklaruan se do të bëhet ndërhyrje emergjente në autostradën Tiranë-Durrës dhe për këtë është hartuar një plan operacional i ndërhyrjes dhe devijimit të trafikut për të shmangur bllokimin e qarkullimit dhe garantuar mbarëvajtjen e punës në terren. "Gjatë ditës së hënë dhe të martë do të bllokohet dhe kryhet ndërhyrja në segmentin e parë nga Qafë Kashari në drejtim të Vorës. ARRSH dhe Policia Rrugore u kërkojnë drej-

tesve të mjeteve sa vijon: Lëvizja e mjeteve të rënda në drejtim të veriut duhet të bëhet përmes Kamzës nga rreth rrotullimi Casa Italia. Autoveturat që shkojnë në drejtim të Durrësit do të përdorin daljen tek pika e furnizimit Kastrioti dhe mbikalimin për Kashar në drejtim të Vorës. Drejtuesit e mjeteve që kanë si destinacion jugun, duhet të përdorin drejtimin nga Elbasani si dhe kthimin për Tiranë të përdorin sërish drejtimin nga Elbasani.

Drejtimesit e televizioneve kryesore në vend, takim konsultativ me Autoritetin e Mediave Audiovizive

Ligji i ri, pronarët gjejnë konsensus tek AMA

Propozimi për të ndryshuar "mediat audiovizive", Sala: Vëmendje maksimale

Në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA u zhvillua dje një takim konsultativ me kërkesën e përfaqësuesve të televizioneve kryesore private në vend. Takimi kishte në fokus diskutimin paraprak për propozimin e tyre, për një ndryshim në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Ky ndryshim që është përcjellë në AMA, ka për qëllim mbështetjen financiare të subjekteve televizive përmes krijimit të një fondi të financimeve të transmetimeve. Gjatë takimit u diskutua për dobishmërinë e këtij propozimi dhe rëndësinë që ka një financim i tillë për mediat private. Aleksandër Frangaj, drejtor i përgjithshëm i Televizionit kombëtar "Klan", tha se propozimi vjen nga shoqata e mediave dhe pjesës më të madhe të televizioneve private. Kjo ide nuk është e re, por është rikthim i propozimit të bërë në vitin 2012, ku kërkohej krijimi dhe përfshirja e "fondit të transmetimeve" në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Fondi që propozohet të përdoret për



Takimi i djeshëm tek AMA

mbështetjen e TV private propozohet të përftohet prejtarifës së shërbimit për përdorimin e aparatit marrës televiziv. Aplikimi i teknologjive të avancuara në tregun audioviziv ka rritur kostot dhe ka reduktuar të ardhurat nga reklamat, dhe

ky fond pritet të japë impakt në balancimin e tregut.

Irfan Hysenbelliu, president i Televizionit "News 24", u shpreh se e mbështet tërësisht këtë projektligj dhe se kjo praktikë vjen nga eksperiencia evropiane, e cila është tashmë e provuar që funk-

sionon si e suksesshme.

Ilva Tare, drejtore e informacionit në Televizionin "Ora News", theksoi se duke qenë se edhe media private publikun dhe siguron integritimin e një Bordi Etik pranë çdo medie. Ky bord merr përsipër të luftojë

Hysenbelliu



PRESIDENTI I "FOCUS GROUP"

Z. Irfan Hysenbelliu, president i Televizionit "News 24", u shpreh se e mbështet tërësisht këtë projektligj dhe se kjo praktikë vjen nga eksperiencia evropiane, e cila është tashmë e provuar që funksionon si e suksesshme.

Carlo Bollino nga "Report TV" vlerësoi se ligji është siguri edhe për gazetarinë investigative, duke promovuar lirinë e medias dhe rritur luftën kundër 'fake news'.

Ben Blushi, drejtor i përgjithshëm i Televizionit kombëtar "Top Channel", u shpreh se ky projektligj është tashmë i konsultuar dhe ai tenton të rregullojë përfundimisht tri aspekte të rëndësishme: raportin e televizioneve në tregun mediatic, raportin e tyre me publikun dhe siguron integritimin e një Bordi Etik pranë çdo medie. Ky bord merr përsipër të luftojë

lajmin e rremë. Ky projekt për z. Blushi, rrit pavarësinë mediatike dhe i ka të gjitha arsyet të miratohet sa më shpejt. Nga ana e tij, kryetari i AMA-s, z. Gentian Sala, vlerësoi partneritetin e institucionit me operatorët në treg, duke vlerësuar çdo propozim dhe iniciativë që vjen nga grupet e interesit. "Ky propozim përfshin disa problematika dhe kërkon angazhimin e sa më shumë aktorëve në konsultime", tha ai duke siguruar se do të ketë vëmendje maksimale gjatë diskutimit dhe vendimmarrjes përkatëse nga Bordi i AMA-s.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Publikohet edhe lista me vendimet e reja për vitet 1993 deri në vitin 1998

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka publikuar dje regjistrin e vendimeve për individët që...

ATP/ Kompensimi i pronave, 2076 vendime për vitet 1993 dhe 2000

Agjencia e Trajtimit të Pronave: Ja kuji është njohur e drejta

Pagesë brenda vitit, brenda tre vjetësh ose brenda 5 vjetësh. "Gazeta Shqiptare" publikon formularët që mund të plotësohen për të përfituar nga përparësitë që jep ligji i ri për marrë kompensimit dhe nga pagesat e përshpejtuar. Pronarët duhet të paraqitin në ATP të plotësojnë formularin tip dhe të zgjedhin një nga tri afatet që parashikon ligji.

TRI AFATET

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuar.

Pagesë brenda një viti, brenda tre vjetësh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçëm është përcaktuar edhe përgjindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së fakturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e

kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pa varësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas

kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor.

të kompensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

2076 VENDIME PËR VITET 1999 DHE 2000

Table with 4 columns: Data/Doje q arkur, Emri (subjekti kërkuës), Vlerësimi, and details of the decision (date, location, name, amount).

Main table containing names, birth dates, professions, and amounts. Columns include names, birth dates, professions, and amounts. Includes entries for Vlorë, Korçë, Berat, and other regions. Some entries have specific dates and names like 'Trashigimtarët e Zelen Kruja' and 'Makhamut Turdiju'.

Table with multiple columns listing names, dates, and locations. The table is organized into several columns, likely representing different regions or categories. The entries include names of individuals and locations, along with specific dates and times.

Kreu i SHBA-ve mbërrin në Singapor, pritshmëritë e takimit historik

Sot samiti Trump-Kim, drejtuesit shfaqin optimizëm

Dimensioni ushtarak i Koreve, marrëdhëniet ndër vite

Sot pritet të zhvillohet samiti i Singaporit, i cili mund të stabilizojë një nga rajonet më të militarizuara në gjithë botën. Pas dy Koreve të armatosura në maksimum gjenden partnerë aleancash, që, gjithashtu, janë rivalë mes tyre. Sot, në Singapor, pritet të zhvillohet një nga takimet më historike mes të parit të SHBA-ve, Donald Trump, e drejtuesit të Partisë së Punës të Koresë së Veriut, Kim Jong Un. Ndërkohë që ky takim i shumëpritur është paraprindë nga shkëmbime deklarata dhe një retorikë agresive në vitin 2017 dhe në pranverën e vitit 2018. Në atë kohë, Trump kërcënoi Korenë e Veriut me "zjarr dhe zemërim" duke e quajtur Kimin një "si predhaxhi me mision vetëvrases" dhe "të çmendur". Ndërsa Koreja e Veriut e quajti Trump "plak matuf", "të çmendur" dhe tha se nuk ka frikë as nga një "luftë totale". Ndërsa këto nuk mbetën vetëm kërcënime, por Koreja e Veriut i shoqëroi ato edhe me prova raketa për ta bërë situatën edhe më serioze. Kjo për të kujtuar se retorika s'ishte boshe. Që prej Luftës së Koresë të vitit 1953, në gadishullin korean gjenden përballë njëra-tjetrës, dy prej ushtrive më të mëdha të botës. Sipas indeksit të Institutit Ndërkombëtar BICC në Bon, Koreja e Jugut është një nga vendet më të militarizuara në botë. Ajo zë vendin e gjashtë në të gjithë botën në indeksin e fundit të BICC-për vitin 2016. Nga 24 milionë banorë që ka vendi 1.2 milionë koreanveriorë shërbejnë në ushtri.



Megenëse nga Koreja e Veriut nuk ka informacione të plota dhe të besueshme, ajo nuk përfshihet në indeks, por mund të supozohet se edhe aty ka "një shkallë të lartë militarizimi", tha për DW-në Marius Bales nga BICC. "Kjo është e qartë, kur nga 24 milionë banorë 1.2 milionë shërbejnë në ushtri". Kujtojmë, gjithashtu, se pas dy Koreve të armatosura në maksimum gjenden partnerë aleancash, që, gjithashtu, janë rivalë mes tyre. Marrëdhëniet mes Koresë së Jugut dhe SHBA-së u sanksionuan në vitin 1953 edhe

me një aleancë ushtarake. Në vitin 1961 Koreja e Veriut nënshkroi një traktat miqësie me Kinën dhe Rusinë, i cili përfshin edhe ndihmë të ndërsjellë ushtarake dhe ekonomike. Rusia e anuloi paktin e ndihmës ushtarake, me Kinën, ajo është ende në fuqi. Japonia, e cila, gjithashtu, ndjehet e kërcënuar nga Koreja e Veriut, luan një rol të veçantë, sepse nga njëra anë është aleat i ngushtë me SHBA-në, por nga e kaluara ka me Korenë e Jugut një marrëdhënie të tensionuar nga e kaluara koloniale dhe Luf-

ta e Dytë Botërore. Sa u përket armëve si Koreja e Jugut edhe ajo e Veriut kanë shumë tanke dhe armë artilerie. Kjo tregon se ushtritë e tyre janë të përgatitura për luftime të mëdha fushore në kufijtë e tyre. Koreja e Veriut ka edhe një numër të madh nëndetësesh, të cilat i përdor si potencial frikësues. Megjithatë, në rast se në një konflikt të mundshëm do të ndërhynte edhe makineria ushtarake e SHBA-së, potenciali ushtarak i dy Koreve duket i parëndësishëm. SHBA-ja, si dhe Kina, kanë raketa me

rrze të gjatë veprimi që mund të pajisen edhe me mbushje bërthamore. Koreja e Veriut ka armë bërthamore, por se sa të afta janë ato për t'u përdorur nuk dihet me saktësi. Gjithsesi përparësia e SHBA-së në fushën e armatimit dhe të teknologjisë ndaj Koresë së Veriut është aq e madhe, sa në një rast lufte që e fundit s'do të kishte asnjë shans ndaj SHBA-së. Ndërsa pas ardhjes në Singapor nuk ka munguar një reagim i presidentit Trump, i cili në Twitter shkroi se ndihet mirë që ndodhet aty dhe se atmosfera ishte shumë pozitive. Mediave botërore nuk u kanë shpëtuar edhe detaje dytësore nga takimi historik. Bussines Insider shkruan se stafi i Kim Jong-un-it ka sjellë në Singapor edhe tualetin personal portabel, të cilin ai e merr me vete në çdo vizitë brenda dhe jashtë vendit nga frika e ndonjë atentati në forma të ndryshme. Gjithashtu, në media thuhet se përveç trenit personal, udhëheqësi komunist ka tualet edhe në limuzinën e tij luksoze 'Mercedes'. Ajo u shfaq sërisht para kamerave në Singapor, me truporjat që e shoqëronin me vrap, ashtu si në samitin me presidentin koreanogjor, në vijën kufitare mes dy Koreve.

SHKURT

Spanjë, shpëtohen mbi 300 migrantë në Detin Mesdhe

Ditën e djeshme janë ardhur të shpëtohen fatmirësisht 334 migrantë në detin Mesdhe. Kanë qenë autoritetet në Spanjë, të cilat kanë njoftuar se kanë arritur të shpëtojnë migrantët, por fatkeqësisht kanë nxjerrë nga ujërat edhe katër trupa të pajetë. Shërbimet e shpëtimit kanë thënë se migrantët po udhëtonin nga Afrika për në Europë me nënte anije të ndryshme. Në një anije, autoritetet spanjolle kanë gjetur katër trupa të pajetë, së bashku me 49 migrantë. Shërbimet e shpëtimit kanë thënë se shkaku i vdekjes së këtyre migrantëve ende nuk është përcaktuar. Të shtyrë nga konfliktet e dhunshme dhe varfëria ekstreme, dhjetëra mijëra migrantë nga Afrika tentojnë të arrijnë në Europë çdo vit, duke kaluar Mesdheun. Shumica e anijëve me të cilat ata udhëtojnë nuk i plotësojnë kushtet për udhëtime të tilla dhe qindra migrantë humbin jetën çdo vit në Mesdhe. Kombet e Bashkuara kanë thënë se të paktën 785 migrantë kanë humbur jetën këtë vit, në përpjekjet e tyre për të arritur në Europë përmes Mesdheut.

Tmerr në aeroport, avioni përfshihet nga flakët

Një ngjarje e papritur ka ndodhur në aeroportin e Frankfurtit ku një avion i "Star Alliance" është përfshirë nga flakët pasi një kamion që tërhoqte atë ka shpërthyer në flakë. Zjarri është përhapur në kabinën e avionit Airbus A340 të "Lufthansa" ndërsa ishte duke u lëvizur pranë terminalit. Ekipet e shpëtimit nxituan të shuanin zjarrin, i cili e la pjesën e jashtme të avionit tërësisht të nxiirë. Ndërkaq tymi i zi që dilte nga avioni mund të shihej qartë edhe pranë terminalit. Ndërsa një zëdhënës i aeroportit të Frankfurtit ka konfirmuar se fatmirësisht s'ka lëndime të raportuara. Nuk dihet ende nëse pasagjerët ose ekuipazhi kanë qenë në bordin e avionit kur shpërthyer flakët.

Haradinaj: Do shndërrojmë ushtrinë e Kosovës me ligj

Njohja e ushtrisë së Kosovës, Lista Serbe: Lufta me Serbinë nuk ka përfunduar ende

Në Kosovë vijon ende ngërçi lidhur me formimin e ushtrisë së Kosovës. Ka qenë pikërisht opozita e vendit, e cila ka reaguar duke hedhur poshtë zërat lidhur me pohimet se serbët në Kosovë e mbështesin njohjen e saj. Ata janë shprehur nëpërmjet një komunikate për media se në pamundësi për të siguruar kushte më të mira për jetën për të gjithë qytetarët në Kosovë, përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Kosovës ofrojnë luftë dhe tregime separatiste për qytetarët, shkruan "Tg". "Kështu sot deklaruan se për Prishtinën lufta me serbët nuk ka mbaruar, për çka presim reagim më urgjent të bashkë-

RAMUSH HARADINAJ: Baza kushtetuese, mandatimi përmes bazës kushtetuese si opsion është gati se i pamundshëm, sepse kërkon votën e 2/3 të kualifikuara, do të thotë të serbëve. Duke qenë kështu, është vështirë të kalkulojmë se tani e kemi këtë votë. Në një moment të caktuar do të jemi të detyruar ta mandatojmë ushtrinë e Kosovës me ligj", - theksoi Haradinaj.

sisë ndërkombëtare", thuhet në komunikatën e Lista Serbe, sipas së cilës deklarimet e tilla janë të rrezikshme për paqen dhe sigurinë në Ballkan. Për më tepër, kjo parti i është kundërvënë edhe njëherë formimit të ushtrisë së Kosovës, pasi sipas saj është në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe marrëveshjen e Kumanovës, por

edhe interesave të sigurisë së popullit serb në Kosovë dhe shtetit serb. Nga ana tjetër, Ramush Haradinaj, kryeministri i Kosovës, është shprehur se shndërrimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, përmes ndryshimeve kushtetuese është gati i pamundur për shkak të refuzimit të Listës Serbe raporton



"Zeri.info". Ai, tha se kjo gjë është e pamundur për faktin që i duhen dy të tretat e votave të Listës Serbe për t'u bërë ndryshimet kushtetuese. "Baza kushtetuese, mandatimi përmes bazës kushtetuese si opsion është gati se i pamundshëm, sepse kërkon votën e 2/3 të kualifikuara, do të thotë të serbëve. Duke qenë kështu, është

LISTA SERBE: "Kështu sot deklaruan se për Prishtinën lufta me serbët nuk ka mbaruar, për çka presim reagim më urgjent të bashkësisë ndërkombëtare", - thuhet në komunikatën e Lista Serbe, sipas së cilës deklarimet e tilla janë të rrezikshme për paqen dhe sigurinë në Ballkan.

vështirë të kalkulojmë se tani e kemi këtë votë. Në një moment të caktuar do të jemi të detyruar ta mandatojmë ushtrinë e Kosovës me ligj", theksoi Haradinaj. Komentet Haradinaj i bëri pas takimit të Këshillit Ministror për Integrim Evropian, ku u diskutua për gjendjen e zbatimit të agjendës për reforma evropiane.



ICMP falë ADN-së gjen 100 për qind identitetin e viktimës dinjitetshëm

Kërkime në malin e Dajtit për trupat e pushkatuar nga diktatura

Luigj Ndou: BE e financoi projektin, na ka dhënë edhe mbështetje politike

Një projekt i financuar nga Bashkimi European Direct link, do të nisë kërkimin e dhjetëra trupave të vrarë nga diktatura komuniste. Qeveria miratoi këtë javë një marrëveshje me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe identifikimin e mbetjeve të 13 trupave të pushkatuar nga diktatura në malin e Dajtit, të gjetura para 8 vjetësh, si dhe me kërkime të tjera në Dajit dhe në kampin punës së detyruar të Ballshit. Zyrtari i lartë politik pranë ICMP, Luigj Ndou, thotë se ky është një hap i rëndësishëm për obligimet e Shqipërisë ndaj instrumenteve ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe të drejtës së familjes për të pasur një hetim të efektshëm të rasteve individuale të zhdukjeve me forcë. "ICMP është jashtëzakonisht e inkurajuar nga marrëveshja e arritur me qeverinë shqiptare, e cila i hap rrugën një procesi jashtëzakonisht në kohë dhe që ka të bëjë me identifikimin e viktimave të regjimit komunist në periudhën 1944-91. BE e financoi projektin dhe krahas mbështetjes financiare na ka dhënë edhe mbështetje politike. Krahas kërkimit të trupave dhe identifikimit të viktimave, ICMP është angazhuar të ndihmojë edhe në ndërtimin e një regjistri kombëtar për të gjithë personat e zhdukur gjatë regjimit komunist", - tha zoti Ndou. Fillimisht do të punohet me mbetjet e trupave që kanë mbetur prej 8 vjetësh në Institutin e Mjekësisë Ligjore, kërkime të reja në malin e Dajtit, ku u gjetën ato dhe ku janë bërë shumë ekzekutime të tjera. "Mbetjet njerëzore të 13 trupave të pushkatuar nga regjimi komunist

JONILA GODOLE
"Mbetjet njerëzore të 13 trupave të pushkatuar nga regjimi komunist u gjetën në vitin 2010 dhe prej asaj kohe mbetën në Institutin e Mjekësisë Ligjore pa bërë asnjë identifikim me prokurorinë. Ky fakt i bën skeptikë veprimtarët, që po përplojnë të ndriçojnë krimet e komunizmit" - thotë Jonila Godole, drejtuese e Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë.

Luigj Ndou
"Krahas kërkimit të trupave dhe identifikimit të viktimave, ICMP është angazhuar të ndihmojë edhe në ndërtimin e një regjistri kombëtar për të gjithë personat e zhdukur gjatë regjimit komunist", - tha zoti Ndou.

u gjetën në vitin 2010 dhe prej asaj kohe mbetën në Institutin e Mjekësisë Ligjore pa bërë asnjë identifikim me prokurorinë. Ky fakt i bën skeptikë veprimtarët, që po përplojnë të ndriçojnë krimet



Luigj Ndou, zyrtari i lartë politik pranë ICMP. Jonila Godole, drejtuese e Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë

e komunizmit. Deri tani organi shqiptar i akuzës nuk ka ndonjë përvojë me zbardhjen e krimeve të komunizmit apo raste të mëparshme që të jetë marrë me identifikime të të pushkatuarve e të zhdukurve nga diktatura" - thotë Jonila Godole, drejtuese e Institutit për

Demokraci, Media dhe Kulturë. Bazuar në të dhënat e autoriteteve për disa vendndodhje me trupa të pushkatuarish, ICMP pritet t'i verifikojë zonat bashkë me zyrtarët shqiptarë për vendvarrimet e mundshme para se të nisin gërmimet. Ekspertët e ICMP pohojnë se falë anal

izave të ADN-së, ata gjejnë në masën gati 100 për qind identitetin e viktimës dhe ua dorëzojnë familjarëve për një varrim të dinjitetshëm. Ekspertët nga ana e tyre kërkojnë bashkëpunimin e gjithë shoqërisë për të sjellë sa më shumë fakte dhe dëshmi mbi ngjarje dhe vendn-

dodhje të krimeve komuniste. Por mosbesimi i veprimtarëve bëhet më i madh kur mendon se bëhet fjalë për një numër të madh vendvarrimesh në shumë dekada. ICMP është organizata e vetme në botë, që merret me personat e zhdukur.

PROTESTA

Fatmira Nikolli

Artistët, ultimatum qeverisë: Anuloni shembjen e teatrit, ose do e uzurpojmë!

"Do e ruajmë me turne, i themi Ramës atë që i tha Robert de Niro Donald Trampit"

Protesta për mbrojtjen e godinës, aktorët lënë afat deri të premtën, takojnë Lulëzim Bashën

Ka vijuar edhe mbrëmë protesta e aktorëve për mbrojtjen e godinës së Teatrit Kombëtar. Katër muaj pas nisjes së protestave, qeveria ka nxjerrë një projektligj që i hap rrugë shembjes së tij për të ndërtuar një teatër të ri, për çka aktorët nuk bien dakord, me pretendimin që ai projekt u hap udhë kullave dhe merr truall nga teatri. Gjatë protestës që u zhvillua përpara teatrit, iu la afat qeverisë deri të premtën që të tërheqë projektligjin që i hap rrugë prishjes së Teatrit Kombëtar. "Pas kësaj, nëse ajo nuk tërhiqet, do uzurpohet teatri!", thanë aktorët. Alfred Trebicka u shpreh se, "mënyrat e reagimit janë të ndryshme, të sofistikuar, ose si ajo e Robert De Niros, që është e freskët fare që i tha Donald Trampit 'fuck you'. Dhe në do i themi 'fuck you'", - tha aktori. "Kur në Gjermani nuk u pyetën qytetarët dhe artistët për tatarin, qytetarët dhe artistët e morën teatrin vetë në dorë. E pushuan atë. Teatri është një e mirë publike, që nuk i takon as një ministri, as një drejtori e as një qeverie. Ajo është një e mirë publike, që u takon qytetarëve. Atje, artistët kanë pushtuar teatrin. Nëse shteti nuk ka ndërmend ta mbajë, nëse ka ndërmend ta shembë, duhet të jemi të gjithë bashkë që ta pushtojmë këtë teatër. Nëse shteti nuk e do, e marrim ne dhe do e administrojmë ne, por do ta ruajmë këtë teatër", tha Kastrioti Çipi, regjisor i dhe ish-drejtor i Teatrit Eksperimental. Në vijim, Robert Budina tha se është ftesa e fundit është që qytetarët e Tiranës të bashkohen të premtën në një tubim paqësor e në mbrojtje të dinjitetit. "Të na bashkohen, sepse jemi këtu për një kauzë qytetare, ju ftojme ditën e premtë në orën 19:00 që t'i kërkojmë qeverisë të tërhiqet nga projektligji".

AKTORËT DHE OPOZITA

Gjatë ditës së djeshme media ka raportuar për një takim të kreut të opozitës, Lulëzim Bashka me aktorët. Ata janë parë në një kafene në kryeqytet, ndërsa aktorët kanë kërkuar më herët ndihmën e të gjithë aktorëve politikë për mbrojtjen e godinës. "Ministria e Kulturës në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ka publikuar për konsultim projektligjin për përcaktimin e një procedure të veçantë negociimi me kompaninë 'Fusha' sh.p.k., së cilës do t'i jepet falas e gjithë qendra historike e Tiranës, për të shembur Teat-



miht në harresë", thuhej në deklaratën e Aleancës. Ajo shtonte se u është shpjeguar të gjithë aktorëve vendimmarrës se pse nuk duhet shembur Teatri Kombëtar për të ndërtuar kulla, se ka vlera arkitekturore, se ka nevojë për teatro të tjerë dhe jo për shembjen e atyre që kemi. "Sa e sa orë, ditë, muaj të shpenzuara pa ulodhur në përpjekjet tona të shumanshme për të bindur këta vendimmarrës të na dëgjojnë,

rin Kombëtar dhe për të ndërtuar kulla biznesi", tha gjatë ditës së djeshme kryetarja e Komisionit parlamentar të Medias, Albana Vokshi. Ajo i ka quajtur korruptive veprimet e kryeministrit Edi Rama, ministres së Kulturës, Mirela Kumbaro dhe kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, për të shembur Teatrin Kombëtar dhe për ta pushtuar qendrën historike të Tiranës me kullat e sponsorëve, që i mbajnë në pushtet. Deputetja demokrate tha se Rama hartoi një projektligj të posaçëm, që sipas selisë blu, synon të shpëtojë nga hetimi përgjegjësit e atyre që kanë planifikuar shembjen e

teatrit dhe ndërtimin e kullave. Gjithashtu, sipas demokratëve "me anë të këtij projektligji, Rama pranon automatikisht projektin e prezantuar nga subjekti privat 'Fusha' sh.p.k., pa iu nënshtruar asnjë procesi konkurrimi apo gare të hapur, pa asnjë procedurë konsultimi me grupet e interesit, apo me qytetarët, edhe pse ai përfshin tjetërsimin e pasurive publike dhe prishjen e Teatrit Kombëtar, që është monument kulture dhe paraqet vlera të veçanta, që mbrohen nga legjislacioni në fuqi".

THIRRJA PËR REZISTENCË

Aleanca për Mbrojtjen e

Teatrit ka bërë edhe një thirrje për rezistencë, duke kërkuar mbështetjen e qytetarëve. "Ka mbi 4 muaj që komuniteti i artistëve së bashku me një grup të gjerë intelektualësh dhe qytetarësh ka dalë hapur kundër prishjes së Teatrit Kombëtar. Në çdo komunikim me publikun si edhe me politikanët apo të zgjedhurit, përfshirë ministrin e Kulturës, kryetarin e Bashkisë Tiranë dhe kryeministrin e Shqipërisë, si palë të njëanshme vendimmarrëse, kemi artikulluar qartë jo vetëm nevojën e ruajtjes të paprekur të godinës ekzistuese, por edhe domosdoshmërinë e restaurimit të godinës historike të Teatrit Kombëtar, të lënë qëlli-

për të bindur kryeministrin Rama të heqë dorë nga ideja e tij e çmendur dhe konstante e prej më shumë se 20 vjetëve për të shembur teatrin. Por të gjitha këto kanë rënë në vesh të shurdhër! Përkundrazi, prej pak ditësh qeveria shqiptare ka propozuar një projektligj të jashtëzakonshëm për t'i dhënë një kompanie të vetme private, kompanisë 'Fusha' sh.p.k., pa asnjë garë tokën e Teatrit Kombëtar, duke i hapur rrugë shembjes së godinës historike", thotë në deklaratë Aleanca. Ata kanë vendosur të kalojnë nga fjala tek akti, nga ligjërimi tek rezistenca! "Ne nuk do t'ju lejojmë të na grabisni një tjetër pasuri kombëtare, në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e këtij vendi! Ta dini se ne do na keni aty përballë, tek pasuria jonë e çmuar, Teatri Kombëtar! Do na keni përballë tek pronajonë publike, që doni të na e rrëmbeni! Nëse nuk tërhiqeni, do na keni përballë me protesta edhe tek ministria, tek bashkia, tek Kryeministria e tek parlamenti. Jua premtojmë këtë!", vijon deklaratë. Në fund të saj, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, thotë se "ftojmë në këtë rezistencë paqësore, të gjithë aktorët dhe regjisorët e teatrit, të gjithë artistët dhe intelektualët, të gjithë banorët e Tiranës e qytetarët e këtij vendi të na bashkohen përpara teatrit që të tregojmë vendosmërinë dhe rezistencën tonë në mbrojtje të godinës historike të Teatrit Kombëtar, në mbrojtje të hapësirës sonë të përbashkët, në mbrojtje të trashëgimisë, historisë dhe identitetit tonë kulturor dhe kombëtar".



Opinion i Ditës

Negociatat, si njëqind vjet më parë

Nga Andon Andoni

(vijon nga faqja 1)

... përvijojë edhe më tej "fajet" dhe sjelljet ndikuuese negative të pozitës qeverisëse dhe opozitës në vend, çfarëdo të jetë vendimi i Komisionit European në lidhje me çeljen e negociatave.

Arsyet janë të ndryshme. Kjo lloj analize është bërë dhe do vijojë të bëhet më e plotë edhe pasi ky proces të jetë përmbyllur.

Në këto rradhë nuk kemi fort synimin të merremi me këtë gjë, porse duke hedhur një sy në 100 vjet më parë, në verën e vitit 1918, duket qartazi se grindjet alla shqiptarçe do jenë edhe tani një nga arsyet kryesore të qëndrimit europian dhe me gjerë, ndaj këtij populli që nuk mundi dot kurrë të flasë me gjuhën e tij, por të një klase politike aspak përfaqësuese.

Në pranverën e 1918 shqiptarët e Amerikës, prej nga dirigjohe dhe tërë lufta dhe përpjekja për një mëvetësi shqiptare, ishte e ndarë në dy rryma, të cilat Kostë Çekrezi, përfaqësuesi "Vatres" pranë Departamentit të Shtetit, dhe dy vite më vonë edhe i Qeverisë së Lushnjës, i emërtonte grupi Bashkimdashës (d.m.th që donte bashkimin me Partinë Politike të Kristo Dakos, nënkupto opozita e sotme,) dhe grupi Fanolist. Nga burimet e ndryshme rezultoi se këto dy grupe përfaqësonin dhe dy tendenca në vijën politike të "Vatres" për sa i përket mbështetjes së vendit nga një fuqi e huaja. Rryma që kryesohej nga Çekrezi, ishte për një politikë më të moderuar, më tolerante ndaj Italisë. Ndërsa Noli, kishte mbajtur një qëndrim të prerë ndaj synimeve italiane, qëndrim i cili kishte shkakuar dhe reagimin e diplomatëve italianë në Washington. Ekzistencën e këtyre rrymave e provon vetë K. Çekrezi, i cili në raportin e tij mbi qëndrimin në Kuvendin e "Vatres" kishte sulmuar memorandumin e marsit të "Vatres" kundër protektoratit italian për "gjuhën e ashpër të tij" dhe e kishte detyruar komisionin Drejtues të "Vatres" të bënte autokritikë për këtë "gabim". Por Çekrezi theksonte, gjithashtu, se dënimi i Komisionit të "Vatres" nuk u shënuar në rekordin (procesverbalin) e kuvendit "meqë delegatët kishin frikë se mos dukej që na pëlqen Protektorati italian". Ky pohim i dytë bën të qartë se të gjithë delegatët e "Vatres" përfaqësues të shqiptarëve të Amerikës, ishin kundër protektoratit dhe aneksimit të Vlorës, por mendimet e tyre ndryshonin vetëm për qëndrimet taktike që do të mbahehin ndaj kësaj politike të Italisë.

"Vatra" vazhonte të insistonte në kërkesat e saj që qeveria italiane në radhë të parë të ndiqte një politikë të hapur ndaj Shqipërisë dhe, së dyti, ajo "të ndikonte që të ndreqeshin padrejtësitë e Konferencës së Londrës". Udhëheqësit e "Vatres", dhe ndër ta kryesisht Çekrezi, u shprehën për bashkëpunimin me Italinë, në qoftë se kjo e fundit do të bënte një deklaratë



formale ku të mbështeste një shtet të pavarur shqiptar, i cili do të përfshinte brenda kufijve të tij të gjithë territoret që dominoheshin nga populli shqiptar. Me "mashën italiane" donin të nxirrte nga zjarri "gështenjat e nxeha" shqiptare; dhe të bashkonin me mëmëdheun Kosovën dhe Çamërinë.

Si hap të parë të domosdoshëm në realizimin e programit të saj politik, "Vatra" konsideronte krijimin e një qeverie kombëtare, e cila do të përfaqëonte Shqipërinë në Konferencën Paqes. Në një artikull redaksional të "Revistës Adriatike", Çekrezi si kryeredaktor i saj, theksonte se "Puna e vërtetë për formimin e qeverisë filloi kur Mehmet Konicë, delegati i "Vatres" në Angli, shkoi në Shqipëri me qëllim që të konfirmohej me udhëheqësit e atjeshëm shqiptarë". E kësaj kohe është dhe marrëveshjen që u arrit më qeverinë italiane për thirrjen e Kongresit të Durrësit dhe për formimin e Qeverisë së Durrësit. Ishte koha kur Lufta e Parë Botërore kishte ulur siparin në 11 nëntor 1918, por shpresat dhe dëshirat e shqiptarëve për një pavarësi pas luftës, dhe me "ndihmën" italiane tashmë ishin edhe më të vagëlluara dhe të errëta. Letrat ende nuk ishin hapur të gjitha dhe nën mëngën e diplomacisë botërore shiheshin ato më të rëndësishmet dhe më me peshë. Koha do tregon te se si do luheshin.

Pas përfundimit të luftës, shpresat e shqiptarëve të Amerikës ishin rritur shumë për rolin pozitiv që mund të luante tashmë diplo-

macia amerikane në drejtim të zgjidhjes së çështjes shqiptare. Pranë kauzës shqiptare ishin grumbulluar dhe njëdjetëra personalitete të këtij vendi të madh të lirisë, që nga shkrimtarë e profesorë universitetesh dhe deri diplomatë të lartë të shtetit. Kostë Çekrezi ishte një ndër më aktivët në ballë të përpjekjeve për të siguruar përkrahjen e shtetit amerikan. Dashuria e vjetër italiane, ishte lënë pas në fund të 1918-ës. Sytë ishin kthyer nga Amerika, e cila ishte larg dhe nuk do kishte kurrë pretendime territoriale si fqinjët. Dashuria shqiptare ishte e qartë. Në listën e kontributeve të dhëna nga emigrantët e kombësive të ndryshme që jetonin në SHBA, si pas dokumenteve të publikuara në atë kohë nga Departamenti i The-sarit i Qeverisë Amerikane, rezultonte se emigracioni shqiptar për nga sasia e kontributeve të dhëna, renditej në krye të 30 grupeve të emigrantëve të kombësive të tjera, në blerjen e bonove të thesarit.

Shpresat e mëdha që kishin varur shqiptarët tek SHBA-ja u shprehën në fjalët historike të Nolit në Camps Devens: "Amerika ka patur në kohën e shkuar një Linkolin që s'mund ta duronte një komb gjysmë të lirë dhe gjysmë rob. Amerika ka tani një president që s'mund ta durojë një botë gjysmë të lirë dhe gjysmë rob". Por, megjithëkëtë, Italia fqinje kishte ende shumë në dorë. Shtu këtu edhe shkopinj të nën rrotë që vendosnin vetë shqiptarët të njëri-tjetrit, e bënte çështjen e njohjes një pro-

lem të koklavitur. Ajo u shtri dhe u gangrenizua edhe gjatë Konferencës së Paqes. Madje, deri pas krijimit të Qeverisë së Lushnjës më 1920. Çekrezi do të shkruante:

"Me të marrë kabllogramin Tuaj (të Mehmet Konicës A. A.) më datë 7 të këtij, në të cilën kishit mirësinë të më jepnit informata, përm'i komplotin e gatuar prej fqinjëve tanë, me Esatin si agjent, vajta që të piqnja sekretarin e Shtetit, pas instrukcjeve të juaja. Por për fat zoti Colby, s'ishte në zyrën e tij atë ditë... por duke mos mundur të takoja zotin Colby më këshilluan që të fjalosem me asistentin e tij, Dr. Albert Shaw, të cilit i shfaqja me gojë punën... dhe pa prituri të mbaronja mirë më pyeti në është frika se mos përsëritet ai komplot! Kur i thashë se po, dhe se tërë këto ngjarje vijnë ngaqë Qeveria jonë nuk është e njohur nga ndonjë anë, Dr. Shaw me pyeti në kisha ndërmend ndonjë mënyrë përkrahje nga ana e shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe mu lut që t'ia shtronja përpara më të shkrojtur: Si përfundim të këtij bashkëbisedimi, përgatita memoranden, një kopje e të cilës e gjeni këtu brenda të cilën ia dorëzova Dr. Shaw, që më siguroi se do t'ia parashtronte menjëherë sekretarit të Shtetit, zotit Colby".

Edhe pse kërkuan një gjuhë të matur ndaj Italisë evropiane, për ta shfrytëzuar si një mundësi mbështetjeje, shqiptarët e Amerikës, u luhat herë-herë edhe për planin amerikan për paqen. Por ata, nuk kishin se si të informoheshin, se për Shqipërinë, nga vetë krerët e diplomacisë ameri-

kane, fillimisht ishte projektuar një kundërshtim i sovranitetit dhe integritetit territorial të saj. "Kommenti zyrtar sekret që këshilltari i Shtëpisë së Bardhë, E. House, u bënte 14 pikave të Willsonit në fund të tetorit 1918, miratonte synimet e Italisë për të vendosur protektoratin mbi Shqipërinë dhe linte të hapur njëkohësisht çështjen e kufijve jugorë, duke vënë në pikëpyetje vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të 1913...". Çekrezi i kishte vënë Komisionit të Presidentit, që drejtohte Zoti Hous, në dispozicion një raport prej 80 faqesh për të drejtat e Shqipërisë, që fatkeqësisht nuk i mori parasysh dhe, në prill të 1919, bëri që presidenti Willson të bënte rekomandimin që Vlorë t'i mbetej Italisë⁷⁸. Çekrezi u akuzua se kishte ndjekur besnikërisht linjën e delegatit të "Vatres", Mehmet Konicës, dhe Turhan Pashës, në përkrahjen e tezës së protektoratit italian, dhe u shigjetua nga Partia Politike si "delja e zezë", si një nga kryesorët e shqiptarëve të Amerikës që mbrojtën protektoratin: "Mehmet Beu... dërgoi edhe këtu në Amerikë urdhër, që "Vatra" të mos nxjerrë asnjë fjalë kundërshtimi kundër kërkimeve ngadhënjuese që kishte shtruar Italia për të aneksuar Vlorën, qarkun e saj dhe për të vënë Shqipërinë e vogël nën protektoratin e saj.

Ndonëse nuk kemi mundur të gjejmë fakte të dukshme, logjika të çon në ekzistencën e mundshme të një nxitjeje të kësaj përçarjeje nga fuqitë e huaja. Ajo mund të ketë ardhur nga misionin diplomatik italian në SHBA⁷⁹. Në një raport të dërguar nga Kostë Çekrezi për Mehmet Konicën, një vit më vonë, dhe ku tregohen përpjekjet e vazhdueshme dhe kontaktet e shpeshta të Çekrezi me ambasadinë italiane në Washington për gjatë atyre dy viteve, kur vetë Çekrezi akthe-kthe kthyer pllakën, dhe tani përkrahte Amerikën, thuhet:

"Me rastjen e ardhjes këtu të gjeneralit Scriven, i cili po përpigjet për neve me fuqinë që ka, vajmte tok te ambasadori i Italisë, duke qenë se desha t'i mbush mendjen Gjeneralit që italianët s'kanë qëllime të mira për neve. Bashkëfjalimi u bë më 2 të këtij. Gjenerali shfaqti hidhërimin e tij se përse shqiptarët dhe italianët të zihen në mes tyre, po ambasadori u përgjigj duke thënë se fajin e kemi neve shqiptarët, gjë të cilën e kundërshtova në mënyrë të atillë që gjenerali u bind prej argumenteve të mia. Pastaj ambasadori duke parë se ra jashtë në atë pikë, tha që Shqipërinë e mori më qafë Amerika, duke qenë se amerikantët dhe më tepër ata të Kryqit të Kuq, i shtynj shqiptarët kundër Italisë duke ju thënë se kanë me vete Amerikën, kurse Amerika po hiqet tani nga ngatërrimet e Europës, duke i lënë shqiptarët në baltë"⁸⁰.

Italianët kishin kohë që e lexonin më mirë se vetë shqiptarët mbështetjen që Amerika po i jepte kauzës së vendit të vogël malor në mes të



Dje në "Deutsche Welle"

Kush e ruan hapësirën ajrore të Serbisë dhe rajonit?

Nga Samir Huseinović

(vijon nga faqja 1)

... e katërta në Evropë. Aviacioni ushtarak ka pasur 400 avionë, ndër të cilët edhe 98 MiG-21 dhe 16 MiG-29. Por me shpërbërjen e shtetit, janë shkatërruar edhe forcat e armatosura. Një pjesë e madhe e aviacionit ushtarak është shkatërruar gjatë luftërave në Bosnje, Kroaci dhe ndërhyrjes së NATO-së në vitin 1999.

Që nga data 5.06.2018, hapësirën ajrore e mbrojnë avionët e NATO-s (Italisë dhe Greqisë) dhe me këtë hap është përmbyllur sistemi mbrojtës malazez në kuadër të aleancës veriatlantike. Kroacia është po ashtu anëtare e NATO-s. Ajo ka avionë të vjetruar MiG-21, por së shpejti do të ketë avionë izraelitë F-16 Barak. Serbia është furnizuar nga Rusia me avionë MiG-29, të një prodhimi më të vjetër, por të cilët teorikisht mund t'u kundërvihen disa avionëve perëndimorë.

Forcat e armatosura të Bosnje-Hercegovinës kanë kapacitete më modeste, sepse ky vend ka vetëm disa helikopterë të vjetër dhe probleme të mëdha për mirëmbajtje. Për avionë modernë Bosnje-Hercegovina nuk ka para.

BOSNJË-HERCEGOVINA, PA AVIONË LUFTARAKË

Analisti ushtarak Nexhad Ahatoviç thotë se blerja eventuale e avionëve varet nga përcaktimi i Bosnje-Hercegovinës që të jetë pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Në kushtet normale, forcat e armatosura të këtij vendi do të duheshin të pajiseshin në dy faza. Së pari, Bosnje-Hercegovina do të duhej të blinte avionë Super Tucano, për shkak të kostove të ulëta. Ndërsa në fazën e dytë pas futjes në NATO, ky vend do të mund të mendonte për avionë të cilësishë së lartë, thotë Ahatoviç.

Ndërsa analisti nga Zagrebi, Igor Tabak thotë, "se fuqia e forcave të armatosura varet nga mundësia financiare. Në Kroaci kemi një shumë relativisht modeste të parave që ndahen për mbrojtje dhe për mirëmbajtjen e avionëve disa dekada të vjetër. Kroacia, e cila aktualisht ka avionë të vjetër izraelitë, së shpejti do



të detyrohet ta trajtojë këtë çështje sërish, sepse duhet të jetë pjesë e mbrojtjes së hapësirës ajrore të BE-së", thotë Tabak.

KROACIA, PRA SFIDAVE TË REJA

Në dallim nga Serbia, e cila po e forcon flotën e avionëve MiG-29, Kroacia është futur në një fazë tjetër të ndryshimeve logjistike dhe teknike. "Kroacia i ka zëvendësuar MiG-21 me avionë F-16, të cilët janë përdorur dikur në Izrael". Analisti nga Beogradi, Andrej Mlakar, pranon se Serbia nuk mund të përballet me NATO-n, veçanërisht jo kur bëhet fjalë për avionë. Por ajo ka vendosur që të ruajë kapacitetet e veta dhe të mos paguajë të tjerët për mbrojtjen e hapësirës së saj ajrore. "Kjo rrugë e Serbisë ka nisur me blerjen e gjashtë MiG-29 nga Rusia vitin e kaluar si dhe aftësimin e katër avionëve që ka pasur. Kështu, është krijuar një flotë e avionëve për ruan-

tjen e hapësirës ajrore, me detyrë "air policing". Në fakt, Serbia ka blerë kohë, sepse më së largu pas 10 vitesh do të detyrohet të blejë avionë të tjerë", mendon Mlakar.

KUSH PO SHKON NË LINDJE E KUSH NË PERËNDIM?

Në ç'drejtim do të shkojnë vendet "neutrale" ballkanike, varet nga përcaktimi i tyre strategjik dhe raportet ndërkombëtare. Mlakar mendon se pozita aktuale "neutrale" e Serbisë nuk do të mund të qëndrojë për një kohë të gjatë. "Nuk mund të kesh bashkëpunim të ngushtë me NATO-n dhe Partneritetin për Paqe dhe njëkohësisht të bësh manovra me Rusinë, e në fund të flasësh se je neutral. Raportet Rusi-NATO janë të tensionuara. Nëse jemi neutralë, atëherë duhet t'u shmangemi manovrave me Rusinë dhe programeve të bashkëpunimit me NATO-n. Por këtu kemi të bëjmë me një politikë të ngjashme si ajo

e Jugosllavisë kur thuhet se jemi neutral dhe të pavarur". Pohon Mlakar. Analistët janë të mendimit se siguria në Ballkan varet edhe nga raportet Rusi-NATO. Nexhad Ahatoviç pohon se do të ishte mirë sikur disa faktorë në Serbi dhe Bosnje-Hercegovinë të kuptojnë se jo edhe shumë gjatë do të mund të bllokohet zgjerimi i NATO-s në Ballkan. "Bllokimi i influencës ruse në këtë pjesë të Evropës është një interes strategjik për Perëndimin dhe aleancën ushtarake. Ndajrje të tjera dhe kufij të ri në Ballkan nuk do të ketë, ndërsa është e domosdoshme njohja e shtetit të pavarur të Kosovës dhe normalizimi i sistemit politik të Bosnje-Hercegovinës. Rruga e vetme logjike e Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës është anëtarësimi i plotë në BE dhe NATO, që do të përcaktonte edhe strukturën dhe sistemin e tyre të mbrojtjes", thotë Ahatoviç.

HOROSKOPI

DASHI
Edhe pse dini të manovroni më së miri duke u mbështetur në vetvetë, mos e refuzoni ndihmën që do t'ju japë një mik. Do të kërkoni dhe do të gjeni, me Marsin dhe Venusin që ju mbështesin, mundësi dialogu dhe bashkëpunime me personin e dashur.

DEMI
Bashkëprejimi i planetëve do të bëjë që humori juaj të ketë luhajtje. Mos u nbyllni brenda vetes. Pranoni dhe besojuni të tjerëve. Për të arritur në një mirëkuptim më të madh, vëreni veten në vendin e partnerit dhe bëni më të mirën që mundeni.

BINJAKET
Me Saturnin që e keni kundra, mos flisni shumë në ambientin e punës. Mos krijoni konfidencë. Mundohuni të mos tregoni sesi ndiheni. Mos u ndruani dhe ithoni ato që ju thotë zemra, edhe pse keni frikë se personi i dashur përkrah jush mund të mos ju kuptojë.

GAFORJA
Do të jeni të frymëzuar për të mposhtur çdo mendim shkatërrimtar, do të përvishni mëngët dhe do të përmblushni me zell punët tuaja. Në fillim kush ju intereson do t'i përgjigjet ftesës me droje, por më pas do të dorëzohet nga sharmi juaj.

LUANI
Keni shumë pritshmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte mirë të qëndroni vëmendjen diku tjetër. Mos u bëni kokëfortë! Keni dëshirë të madhe të imponoheni në të gjitha rrethanat. Do të ishte mirë që të mendoheshit pak.

VIRGJERESHA
Të paplurta të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë deikate. Do të fitoni kështu vlerësimin e një eprori.

PESHORJA
Partneri më në fund do të jetë në lartësinë e duhur që kërkoni situata dhe nuk do të shqetësohet nga përgjigjet që do t'u jepni kërkesave që ka. Nëse do të zgjidhni të jeni më emocional, do të jeni më pak bujar dhe të përfshirë, por me siguri më të qartë dhe të qetë.

AKREPI
Nëse në jetë e në çift xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepni fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejtim. Plutoni nuk shkon mirë me Saturnin! Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

SHIGJETARI
Disa kërkesa për pushtet në çift nuk funksionojnë. Hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që hanë diskutim. Duke këmbëngulur do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

BRICJAPI
Sot mund t'ju dalin gjëra të paparashikueshme. Për të shmangur tensione, ndiqni atë që ju thotë zemra, edhe pse mund të interpretohet si një dobësi. Do të keni një ditë që prirret drejt përtacisë, por që nuk pajtohet me angazhimet tuaja të shumta.

UJORI
Ditën e sotme përpiguni ta shfrytëzoni çastin e mirëqenies shpirtërore për të dëgjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes. Me Saturnin që ju del kundra, priten disa përgjegjësi që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirshëm.

PESHQIT
Nëse keni programur një udhëtim, do ta menaxhoni më mirë lodhjen dhe përshtatjen ndaj rritmeve të mëdha të punës, me Plutoni mik që ju favorizon. Kriidhuni në ndonjë aventurë të bukur, zbuloni një horizont të ri dhe jetojeni me gjithë shpirt.

Ballkanit. "Ambasadori (Italian, A.A) më tha një gjë të çuditshme; shkruan Çekrezi, - që kishite vajtur në Departamentin e Shtetit dhe kishite protestuar tek sekretari Colby kundra propagandës që po bënte kryqi i Kuq Amerikan në Shqipëri përmes të cilës, Amerika do që të sigurojë mandatorin në Shqipëri".

Xhelozia mes palëve të politikës shqiptare të kohës bënte që "Albania" e Kristo Dakos të shprehej; "Kur presidenti Willson bëri rekomandimin që Vlorë t'i mbetej Italisë ishte nën përshtypjen se

Kabineti i Turhan Pashës, anëtarët e "Vatrës" që formojnë shumicën e shqiptarëve të Amerikës edhe përfaqësonjësi i tyre, i përndërçmi Noli, të cilin pati interesin ta pjejë në vaporin Mayflower, nuk kanë asnjë kundërshtim që Vlorë t'i jepet Italisë, edhe kështu e bëri rekomandimin që Vlorë t'i mbetet Italisë"¹¹.

Efektet e përçarjes të diasporës shqiptare në Amerikë ishin me pasoja të cilat u ndjenë, më gjerë deri në mëmëdhe. së pari treguan ftohjen miqtë e Shqipërisë, disa nga personalitetet e shquara albano-fille të Amerikës krijuan opinion-

in se "për shkak të grindjeve, shqiptarët nuk do të ishin në gjendje të drejtonin vetë shtetin e tyre e, për pasojë, Shqipërisë i nevojitej një Protektorat i huaj"¹².

Këtë fakt e vinte në dukje Dr. Turull në letrën që i shkruante Nolit dhe ai i referohej mikut të madh të Shqipërisë, Carl Krane. Të tilla zhgënjime dhe rrudhje buzësh nga të huajt, miq të Shqipërisë, shqiptarët do t'i vuanin gjatë. Që nga ajo kohë dhe deri në ditët e sotme, për shkak të grindjeve dhe konflikteve të klasës politike.

Me gjasë edhe në fund të këtij

muaji, do të ndodhë e njëjta gjë si njëqind vjet më parë.

(Footnotes)
¹ Po aty, f. 209 "Dielli", dt. 9.12.1918, Delegatit tanë në Shqipëri.
² "Adriatic Review", nr. 5-6, janar 1919
³ "Po aty f. 233" Beqir Meta, "Federata pan shqiptare" Vatra", "Globus R", Tiranë 2002, cituar: Poizla e Shqipërisë, "Dielli", dt. 30.10.1918.
⁴ "Raport i Kostë Çekrezi dërguar Mehmet Konicës, Ministër i Punëve të Jashtme, "Hotel Campbell", Paris, 19 maj 1920, f. 2
⁵ "Harris Sllajkhitic, "Shqipëria dhe SHBA në arki-vat e Washingtonit"
⁶ "Dituria", Tiranë 1999, f. 143
⁷ "The Albania", 10 maj 1919
⁸ Po aty
⁹ "Raport i Kostë Çekrezi, dërguar Mehmet Konicës, Ministër i Punëve të Jashtme, Hotel Campbell, Paris, 19 maj 1920, f. 3
¹⁰ "The Albania", 10 maj 1919
¹¹ Beqir Meta, "Federata pan shqiptare" Vatra", "Globus R", Tiranë 2002, f. 186



Lihet jashtë Skënderbeu, që mbetet në pritje të vendimit të KAS

Nuk ka më dilema, UEFA ka zyrtarizuar ditën e djeshme ekipet që do të marrin pjesë në Kupat e Europës. Kështu, Kukësi do të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve, ndërsa Luftëtari, Partizani dhe Laçi do të jenë pjesë e Ligës së Europës. Qeveria e futbollit evropian mesa duket nuk ka pritur vendimin e KAS-it të Lozanës për

Zyrtare, UEFA çon Kukësin në Champions, Partizani hyn në Europa League

të zyrtarizuar se kush mes Skënderbeut dhe Kukësit do të shkonte në Champions. Klubi korçar pret një përgjigje nga KAS, por gjithsesi UEFA njeh Kukësin si pjesëmarrës në Ligën e Ka-

mpioneve në turin e parë. Shorti do të hidhet më 20 qershor për të dyja kompeticionet. Të gjitha skuadrat e Kategorisë Superiore që do të marrin pjesë në Europë, do të jenë në raundin e parë

kualifikues. Ndërsa, për sa u përket 2 skuadrave kosovare, Drita dhe Prishtina, ato do të marrin pjesë në raundet paraeliminatore, ku do të ndeshen me skuadra të lehta në letër. Edhe 2 skuadrat

shqiptare të Maqedonisë, Shkëndija dhe Shkupi do ta nisin nga raundi i parë astu si Kukësi, Luftëtari, Laçi dhe Partizani. Ky zyrtarizim i skuadrave që do të marrin pjesë në Europë mban në fuqi dënimin e Skënderbeut, i cili është i përjashtuar nga kompeticionet evropiane.

Sa i takon Tomas Strakoshës, Liverpooli ka gati ofertën pasi nuk siguroi dot Alisonin

Mediat italiane shesin Berishën, më pas përgënjeshtrojnë lajmin

Në fakt bëhej fjalë për Valon Berishën e Salzburgut



Jeton Selimi

Disa orë më parë u bë e kryer që Etrit Berisha do të jetë pjesë e skuadrës së Sampdorias. U tha se për portierin kuqezi ishte arritur marrëveshja shumë shpejt dhe dje portieri që mban veshur fanellën e Atalantas do të nënshkruajë me skuadrën nga Xhenoa. Por në këtë mes nuk ka asgjë të vërtetë. Edhe vetë "sampnews24.com", që raportoi lajmin, referuar "Secolo XIX", e ka shirë postimin në sajt, duke lënë të kuptohet se e gjitha ka qenë një ngatërsesë. Prej ditësh është raportuar se Sampdoria kërkon të afrojë në skuadër Valon Berishën, mesfushorin e Kosovës dhe Salzburg. Pikërisht këtu janë bërë lëshimet italianët, duke ngatërruar Valonin me Etritin. Gjithsesi, lajmi se portieri mund të largohet nga Atalanta qëndron, pasi prej ditësh është thënë në mediat italiane se nëse u shkon një ofertë, mund ta shesin Berishën, që vlerë-



sohet rreth 8 milionë euro, tre më shumë nga sa e kanë blerë nga Lacio. Portieri i Shqipërisë, 29 vjeç, mbylli sezonin e dytë tek Atalanta, që e bleu verën e shkruar "gardianin" nga Lacio për shumën e 5 milionë eurove. Igli Tare e pati marrë Berishën në

Suedi nga skuadra e Kalmar për shifrën e 400 mijë eurove. Ai ka edhe tri vite kontratë me skuadrën italiane, pasi i përfundon më 30 qershor të vitit 2021. Sezonin e fundit portieri me Atalantën është aktivizuar në 42 ndeshje (31 në Serie A, 3 në

Kupën e Italisë, 8 në Europa League). **STRAKOSHA** Gabimet e Kairutit në finalen e Ligës së Kampionëve duket se kanë bërë që Liverpoolit të mendojë seriozisht për një portier që mund të japë siguri dhe ga-

ranci për portën. Emri i parë në listën e dëshirave është braziliani Alison Becker, por mesa duket "The Reds" nuk kanë ndërmend të paguajnë shumën e 80 milionë eurove për një portier, ndërkohë që drejtuesit anglezë i kanë hedhur sytë nga Lacio. Portieri shqiptar, Thomas Strakosha është një ndër më të dalluarit gjatë sezonit të kaluar në Itali, duke u përzgjedhur edhe në formacionin më të mirë të vitit për moshat U23. Kjo performancë e gardianit kuqezi ka bërë që drejtuesit e Liverpoolit të mendojnë një ofertë të majme për të. Sipas mediave italiane, oferta e klubit të drejtuar nga Jurgen Klop pritet të kapë shifrën e 30 milionë eurove, shifër kjo, që vështirë se mund të refuzohet nga Lacio, megjithatë, për Strakoshën nuk është i interesuar vetëm Liverpooli.

FORMULA 1



Super rekordi i "Sauber"-it, ndërrim gomash për vetëm 1.72 sekonda

Në garën e zhvilluar në Kanada gjatë ditës së diel, është vendosur një rekord botëror për "Formula 1". "Sauber" ka arritur të ndërrojë 4 gomat e makinës së garës për një kohë rekord prej 1.72 sekondash. Me ardhjen në bokse të pilotit Markus Erikson, ish-in 22 mekanikë që u angazhuan për të vendosur një rekord të ri në këtë sport dhe ia arritën qëllimit të tyre. "Williams" e kishte rekordin më parë me një kohë prej 1.83 sekondash, ndërsa "Sauber" i ishte afruar suksesit edhe më parë, duke i ndërruar gomat për më pak se dy sekonda në dy raste të tjera: në Shanghai për 1.88 sekonda dhe në Barcelonë për 1.96 sekonda. Menaxheri i ekipit është shprehur në përfundimin e garës: "Ne të gjithë krenohemi me këtë arritje. Për këtë kishim punuar prej vitesh", ka thënë Beat Zender. Falë këtij rekordi, piloti Erikson ka arritur të dalë me pikë nga gara e djeshme, duke marrë vendin e 15, pas telasheve që pati gjatë garës.

Napoli nuk do të kërkojë më 50 milionë euro

Hysaj çlirohet nga klauzola milionere më 30 qershor

Eardhmja e Elseid Hysajit lidhet ngushtë me datën 30 qershor, pasi ajo është dita e fundit kur merr fund klauzola e tij e famshme e largimit prej 50 milionë eurosh. Pas asaj date, eardhmja e futbollistit shqiptar është plotësisht në duart e Napolit. Në momentin kur firmosi rinovimin me napolitanët, dy vite më parë, Hysaj përfitoi rritjen e rrogës, por edhe vendosjen e një klauzole largimi. Në këtë mënyrë, për sa kohë që lojtari

gjente një akord me një klub tjetër dhe ai ishte gati të paguante 50 milionë euro, futbollisti shqiptar mund të largohej pa u shqetësuar nga skuadra italiane. Kjo klauzola ka vlerë deri më datën 30 qershor të këtij viti, pasi që nga 1 korriku, çmimin e shitjes së tij e vendos Napoli dhe ofertat duhet t'i shkojnë direkt klubit italian dhe jo futbollistit. Sipas mediave italiane, kjo është arsyeja pse palët presin të shohin nëse ka klube të interesuara realisht për të paguar këtë klauzulë largimi, para se të



merret vendim nëse Hysaj do të shitet apo jo. Gjithsesi, raportohet se Napoli shpreson që ta mbajë edhe për vitin e parë nën drejtimin e Ancelotit, ndaj po mendon realisht që t'i rinovojë marrëveshjen futbollistit të përfaqësueses, sigurisht, pas datës 1 korrik.

Bashkia Shkodër, gati të shesë klubin


Vllaznia, ankandi nis nga 507 milionë lekë të vjetër

Kushdo që dëshiron të blejë klubin e Vllaznisë duhet së paku të bëjë gati 507 milionë lekë të vjetër. Kjo është shumë me të cilën do të nisë ankandi pas vlerësimit që iu bë klubit nga kompania audituese "Albanian Audit Partners" sh.p.k. Kryebashkiakja e qytetit, Voltana Ademi, është shprehur se ankandi do të jetë transparent dhe shitja do të bëhet atëherë nëse kompania i përmbush të gjitha kriteret dhe është serioze. Në raportin 58-faqësh të



bërë publik në faqen e bashkisë është bërë një analizë e hollësishme e KF "Vllaznia" sh.a. dhe dilet në përfundimin se klubi nuk do të shitet poshtë shifrës 507 milionë lekë.

Fjalëkryqi (1)



VERTIKAL

1. Të çara ato të Shollohov.
5. Fillojë luftën.
6. Liszt kompozitor.
8. Marsi në Areopag.
9. Kështu fillon filmi.
11. Gjysmë linear.
12. Një freskues në tavan.
18. Eshhtë gazeta Panorama.
20. Mund të jenë kamikaze.
21. Masat pa kufij
23. Venier e spektaklit italian.
25. Sophia e kinemasë.
26. Safin tenist.
29. Eshhtë makut, i pangopur.
31. Eshhtë faqe ene.
32. Një kafshë që hap... galeri.
33. Një fytyrë e keqe.

35. Preken nga sindroma Basedow.
37. Italia në Internet.
38. Fillojnë vonë.
39. Krijoi James Bond.
40. Ishulli i Odiseut.
42. Van der portier.
43. Një karamelle aromatike.
44. Mund të shkojnë... nga frika.

VERTIKAL

1. Bëhet duke vënë në lojë.
2. Pak origjinale.
3. Thahet me bonifikim
4. Në fund djathtas.
5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
7. Hidhet një për shesh.
9. Kokëkuoja në pit stop.
10. I famshëm ai i Sizifit.
12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
13. Një diktator shtypës
14. Lëvizja Socialiste Spanjole.

15. I kanë çift radhët.
16. Janë llahtarë.
17. Poeti kur nuk pi.
19. Fillojnë perudhën.
22. Omar që qe aktor.
24. Si sezonale.
25. Janë banorët në Riga.
26. Carey këngëtare.
27. Nuk i tregohen babait.
28. Bëjnë arte me re.
29. Kush ka... e ka humbur toruan.
30. Një stacion orbital.
31. Fillojnë profesionin.
33. Gibernau i MotoGp.
34. I kanë të ndryshme tutat
36. Gjysmë ditari.
38. Varet me re.
41. Kufijtë e kujtesës.
42. Sapo fillonjë.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Gustav kompozitor.
6. Në krye të kryesisë.
7. Lexohet në pentagram.
11. Sastre aktore.
12. Gjysmë akordi.
15. Dhjetë angleze.
16. Satira për zë.
18. Eshhtë situata e tensionuar.
21. Pak teatrale.
22. Bëhet me mea culpa.
24. Fundi i një samurai.
25. Mbeten në fund.
26. Lind në kokë.
28. Në radhë të parë.
29. Inicialet e Camus
30. Një verë në Paris.
31. Partizani i vogël... në një film tonin.
33. Litra pa kufij.

VERTIKAL


35. Eshhtë fatë.
36. Një pjesë e kinematografisë.
37. Një pjesë e akademisë.
39. Kufijtë e tretjes.
40. Mbyllt të çarën.
41. Erik çiklist.
43. Një pjesë e medaljes.
44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës
51. Mbyllin një spital.
52. Mbyllt me dorezë.
53. Ishin kalorësit si Rolandi
54. Ndalo në... kryqëzim.

VERTIKAL


1. Janë enigmatike.
3. Mund të jenë parabolike.
3. Litra pa kufij.
4. Kufijtë e lëvizjes.
5. Fillojnë radhijën.
6. Janë kushte.
8. Totem pa ekstreme.
9. Mbyllin kanate.
10. Shoqëronte Edipin e verbër.
13. Eshhtë gjeli.
14. Moore aktore.
17. Janë forcat e Reneas.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin dritaren.
26. Fillojnë matjet.
27. Duhet ruajtur.
32. I bën një serenatë Rosina-s.
34. Gjysmë rabini
38. Mustafa.. Ataturk.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Ai i muzave është Helikona.
45. Një pjesë e gadishullit
47. Muzika e Eminem.
49. Fillojnë operacionin.
50. Kapen të parat.
52. Kufijtë e drejtëzës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		7						6	
	4							2	1
	2			7	8				
9	3			5	4	2			
7	1		8			3			
		6							
			6			1	9		
1				5	4				
		9				5	7		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	6	8	5	2	9	1	3	4
9	1	5	3	6	4	7	2	8
2	3	4	1	7	8	5	6	9
6	5	9	4	8	1	3	7	2
1	4	2	6	3	7	9	8	5
3	8	7	2	9	5	6	4	1
5	9	3	7	4	2	8	1	6
8	2	6	9	1	3	4	5	7
4	7	1	8	5	6	2	9	3

Argëtim filozofik

- Ndonjëherë është më e lehtë të buzëqeshësh dhe të pretendosh se je i lumtur, sesa të shpjegosh pse nuk je.
 - Kurrë nuk i kam përfillur ata që i kanë xhepat plot.
 Kur pashë zemrat e tyre bosh, u dhashë dhe 1 euro.
 - "Gjithmonë dikush do të jetë më i bukur. Gjithmonë dikush do të jetë më i gjatë. Gjithmonë dikush do të jetë më i ri. Por, kurrë dikush do të jetë TI"

Thënie të mëncura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	6		4	6		6	1	4	1	7	
1	15		11	8		8	6		5	L	3	M	A
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7		5	
	6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8	
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7		13	
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7		7	7	
6		13	3		8	13	9			12	1		
16		4	13	13	3		6	1	5	5	3		
1	6	3	1	13	7		17			9	4	8	
15		9	7		8	17	3	16	9	15	8		
3	7	15		8	7	3	5	8	13	3		8	
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1	17	3	

D	R	I	T	A	R	E	T		B	O	T	E
O	R	A	P	F	B	E	L	A	T			
B	I	K	O	L	O	N	E	L	B	I		
I	F	I	T	O	R	E	T		T	E	K	
K	O	M	E	N	T	E	T		E	L	E	
H	A	R	E	M	E	R	E		R	A	T	
T	A	M	T	A	M	A	S	R	A			
S	A	E	D	A	S	T	I					
D	T	E	K	S	T	M	I	T	E	T		
E	H	R	R	I	K	I	L	O	N	I		
M	I	R	I	A	M	K	R	E	R	E	T	
I	T	A	P	I	N	A	T	I	O			

PËR GJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	E	R		P	A	M	O	R	E	
A	M	E	N	K		B	A	N	G	R	E	T
R	A	M	E	I	T	A	E	D	E	M	A	
P	H	E	A	N	A	T	E	M	A	T		
R	E	T	E	L	E	P	A	T	I			
E	K	O	N	O	M	I	K	E	R	E	S	
K	E	N	E	T	A	T	R	O	B	E	R	T
E	M	R		E	H	R	O	M	B	I		
S	T	I	N	G	E	R	T	E	N	A	T	
S	A	J	D	I	T	E	R	L	I	T	O	
S	H	I	I	N	E	N	E	M	I	R		
D	A	M	A	R	I	A	K	T	E	T		
S	P	O	T	P	R	A	A	L	F	A		
A	S	O	P	E	R	A	T	D	A	S		
U	O	P	E	R	A	T	D	O	R	A		
L	I	P	L	I	P	O	T	I	M	I	A	
M	O	N	O	T	O	N	I	I	R	O	N	
L	I	Z	T	O	R	T	E	L	O	N		
A	T	I	A	N	I	E	U	E	N	I	S	
D	I	T	A	H	I	L	U	M	I	S		
A	M	A	N	E	T	A	L	G	A	T	F	
E	I	R	I	S	A	R	E	N	E			
S	T	O	L	I	K	U	R	A	T	A	R	
P	M	A	K	E	T	E	L	E	H	E	T	

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

